FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 91

Tiranë – E mërkurë, 29 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 57/2026, datë 9.4.2026	Për mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore".....	8311
Vendim i Kuvendit nr. 58/2026, datë 9.4.2026	Për mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSH) për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s" ".....	8311
Vendim i Kuvendit nr. 59/2026, datë 9.4.2026	Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	8312
Vendim i Kuvendit nr. 61/2026, datë 16.4.2026	Për emërimin e kryetarit të Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës.....	8312
Dekret i Presidentit nr. 256, datë 17.4.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8312
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 5751/2, datë 27.4.2026	Për hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	8312
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 19.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-509, datë 12.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me një trup tjetër gjykues.....	8313
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 221, datë 22.4.2026	Për miratimin e rregullave mbi menaxhimin e infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit në gjykatat e Republikës së Shqipërisë.....	8325

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 84/7, datë 24.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi projektit "Rikonstruksion i trotuareve, lagjja 'Sheh', Bashkia Kavajë".....	8347
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 519/5, datë 27.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare (Pika Doganore Morinë)".....	8348

VENDIM
Nr. 57/2026

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE DHE MOSVEPRIMEVE TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR PËR REALIZIMIN E INVESTIMEVE NË INFRASTRUKTURËN RRUGORE"

Në mbështetje të neneve 77, pika 2, dhe 78 të Kushtetutës, neneve 7 dhe 8 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", dhe neneve 25 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të 1/4 së deputetëve të Kuvendit, anëtarë të grupeve parlamentare të Partisë së Lirisë dhe Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 9.4.2026.

VENDIM
Nr. 58/2026

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË NË FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSH) PËR VLERËSIMIN E SIGURISË KIBERNETIKE DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE TË QYTETARËVE PËR SIGURINË KOMBËTARE DHE DETYRIMET E SHQIPËRISË SI VEND ANËTAR I NATO-s"

Në mbështetje të neneve 77, pika 2, dhe 78 të Kushtetutës, neneve 7 dhe 8 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe neneve 25 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të 1/4 së deputetëve të Kuvendit, anëtarë të grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe Partisë së Lirisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSH) për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 9.4.2026.

VENDIM
Nr. 59/2026

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Zgjedhjen e zonjës Olta Rushaj anëtare të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 9.4.2026.

VENDIM
Nr. 61/2026

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 21, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Emërimin e zotit Denar Biba kryetar të Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 16.4.2026.

DEKRET
Nr. 256, datë 17.4.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Dion Xhavit Gallapeni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

NJOFTIM
Nr. 5751/2, datë 27.4.2026

NJOFTIM PËR HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Konventa Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës, bërë në Gjenevë, më 20 prill 1929, hyn në fuqi për Republikën e Shqipërisë në datën 16 korrik 2026.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 38, datë 19.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 19.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 19 (F) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Fatmira Allmuça

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, përfaqësuar nga Denald Gjoni, me urdhër delegimi.

Këshilli i Qarkut Tiranë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, përfaqësuar nga përgjegjësi i sektorit Gani Shehu, me urdhër.

Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Farkë, në mungesë.

Nexhmi Allmuça

Kujtim Allmuça, Hafsa Lamaj, Shqipe Barbullushi, Shpresa Biçaku, Teuta Bleta, Ermira Seferi, Rukije Kubati, Merita Gurabardhi, Arta Gurabardhi, Hidajete Mema, Enina Nallbani, Denis Mema, Lumturi Allmuça, Vjollca Hatibi, Lejla Hysi, Sali Allmuça, Edith Zajmi, Artur Zajmi, Dritan Zajmi, Juljan Zajmi, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-509, datë 12.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me një trup tjetër gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* nenet 71, pika 1 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkueses Fatmira Allmuça (*kërkuesja*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë Rurale 1 (*Drejtoria e Kadastrës Tiranë*) e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Tiranë (*Drejtoria e Administrimit të Tokës*), që e kanë lënë në çmimin e Gjykatës zgjidhjen e çështjes, Nexhmi Allmuçës, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është trashëgimtare e një subjekti të shpronësuar (ati i saj). Këtij të fundit, në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Tiranë, me vendimin nr. 407, datë 2.10.1995 *(vendimi nr. 407/1995),* i ka njohur të drejtën e pronësisë mbi një truall 136.000 m^2 (*pasuria e parë*), të ndodhur në lagjen "Ali Demi", Tiranë, i ka kthyer fizikisht 10.000 m^2, i ka njohur të drejtën e parablerjes për një objekt brenda truallit, me sipërfaqe 21.709 m^2, si dhe i ka njohur të drejtën e kompensimit për pjesën tjetër të truallit.

2. Subjekti i shpronësuar ka përfituar edhe nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, si anëtar i ndërmarrjes bujqësore, një truall me sipërfaqe 109.000 m^2 (*pasuria e dytë*), të ndodhur në komunën Farkë, Tiranë. Këtë pasuri, me kontratën e shitblerjes së datës 28.1.2000, subjekti i shpronësuar ia ka shitur kërkueses kundrejt vlerës 1.960.000 lekë. Mbi bazën e këtij veprimi juridik, pasuria është regjistruar në emër të saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme në datën 25.2.2000.

3. Individët e tjerë (të thirrur si subjekte të interesuara në gjykimin kushtetues) kanë ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar njohjen e bashkëpronësisë dhe kthimin e pjesës që i takonte secilit si pasuri trashëgimore, lidhur me pasurinë e dytë. Sipas tyre, prona nuk i përkiste subjektit të

shpronësuar, por atit të tij (gjyshi i tyre dhe i kërkueses), ndaj edhe ata, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë, kishin të drejtën e bashkëpronësisë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3472, datë 23.10.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë, me argumentin se dokumentet e kohës së shpronësimit tregonin se prona i ishte shpronësuar atit të kërkueses. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 602, datë 20.5.2002 (*vendimi nr. 602/2002*), ka vendosur ndryshimin e vendimit, duke pranuar padinë dhe duke njohur të drejtën e bashkëpronësisë për të gjithë trashëgimtarët. Ndonëse ati i kërkueses ka paraqitur ankim, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 365, datë 5.2.2003 *(vendimi nr. 365/2003),* ka vendosur mospranimin e rekursit të tij. Ndërsa Kolegji i Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* me vendimin nr. 117, datë 2.7.2003, ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare të ankimit kushtetues individual, me arsyetimin se nuk ishin parashtruar shkaqe që lidheshin me të drejtën për proces të rregullt ligjor.

5. Më pas, kërkuesja dhe i ati kanë paraqitur dy herë kërkesë për rishikimin e vendimeve nr. 602/2002 dhe nr. 365/2003. Të dyja kërkesat nuk janë pranuar nga Gjykata e Lartë, me vendimet nr. 48, datë 7.6.2004 dhe nr. 00-2010-1127, datë 22.10.2010.

6. Ndërkohë, konflikti gjyqësor për pronat ka vazhduar, pasi bashkëpronarët e njohur me vendim gjyqësor kanë ngritur padi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes së pasurisë së dytë të datës 28.1.2000, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe fshirjen e regjistrimit të pasurisë në emër të kërkueses. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas rigjykimit të çështjes, me vendimin nr. 4462, datë 31.5.2010, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2040, datë 10.10.2011 *(vendimi nr. 2040/2011)* dhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2014-839 (89), datë 10.3.2014. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 104, datë 31.5.2016, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

7. Në datën 29.12.2015 kërkuesja ka paraqitur për herë të tretë kërkesë për rishikimin e vendimeve (të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë) që kanë njohur të drejtën e bashkëpronësisë së trashëgimtarëve të tjerë për pasurinë e dytë. Ajo ka paraqitur si shkak ekzistencën e provave të reja shkresore për pronësinë e të atit të saj, të cilat janë gjetur pranë Arkivit Qendror Shtetëror. Në datën 27.6.2024 ajo ka paraqitur dokumentacion shtesë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2025-509, datë 12.2.2025, ka vendosur sërish mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se aktet e paraqitura nuk përbënin prova të reja sipas nenit 494, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC).*

8. Në datën 2.6.2025 kërkuesja ka paraqitur në Gjykatë ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 5.6.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 16.7.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

9.1. *E drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme*, pasi relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë ka qenë pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili në vitin 2011 ka vendosur në disfavor të kërkueses, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes dhe fshirjen e regjistrimit të të gjithë pronës në emër të kërkueses. Mosmarrëveshja gjyqësore në vitin 2011 ishte midis të njëjtave palë ndërgjyqëse dhe objekti e shkaku i mosmarrëveshjes lidhej me të njëjtën pronë.

9.2. *E drejta e aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë argumentet e kërkueses lidhur me rëndësinë e provave të reja për çështjen. Kërkesa për rishikim plotësonte kriteret ligjore formale dhe përmbajtjesore, ndaj Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte atë në seancë dëgjimore me praninë e palëve, duke u dhënë atyre mundësi për t'u dëgjuar sipas parimit të kontradiktoritetit. Ajo nuk duhej të mjaftohej me një trajtim formal të çështjes.

9.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi shprehja në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Lartë se kërkuesja "nuk ka treguar diligjencën e duhur" në gjetjen e provave, është e pavend. Provat shkresore të siguruara nga Arkivi Qendror Shtetëror nuk janë përdorur asnjëherë në

gjykimet e mëparshme dhe nuk diheshin prej saj, pasi fondi në të cilin ato gjenden është përpunuar dhe pasuruar në vazhdimësi në një periudhë të mëvonshme.

10. ***Subjekti i interesuar, Nexhmi Allmuça,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se argumentet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* janë të paarsyeshme dhe të pabazuara, pasi:

10.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme* nuk qëndron, sepse relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka dhënë vendimin që kërkohet të rishikohet. Për më tepër, ai gjyqtar ka qenë në padijeni të plotë të këtij vendimi.

10.2. Kërkuesja ka bërë kërkesa të përsëritura për rishikimin e vendimit për të njëjtën çështje dhe për të njëjtin shkak që lidhet me gjetjen e tri provave të reja, të cilat janë të ngjashme me dhjetëra prova të nxjerra nga Arkivi Qendror Shtetëror, të depozituara nga palët ndërgjyqëse në dosjen gjyqësore, ndaj asaj i është garantuar *e drejta e aksesit në gjykatë*.

10.3. Kërkuesja ka shtrembëruar faktet, sepse aktet e pretenduara prej saj si prova të reja nuk kanë asnjë lidhje me çështjen dhe nuk vërtetojnë origjinën e pronës në favor të saj, përkundrazi vërtetojnë të kundërtën, se babai i saj ka regjistruar pronën e të atit në emrin e tij dhe gjykatat kanë dhënë vendime të mirargumentuara që përmbushin *standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

11. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria e Kadastrës Tiranë,*** nuk ka mbajtur qëndrim për kërkesën e paraqitur, por ka vënë në dispozicion të Gjykatës aktet e administruara gjatë veprimeve për regjistrimin e vendimeve gjyqësore.

12. ***Subjekti i interesuar, Drejtoria e Administrimit të Tokës,*** nuk ka mbajtur qëndrim për kërkesën, por ka dhënë shpjegime për rolin administrativ të saj lidhur me shërbimin që ofron dhe ruajtjen e dokumentacionit.

13. ***Subjektet e interesuara, Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Farkë dhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë,*** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

14. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kundërshton vendimin e Gjykatës së Lartë, me të cilin nuk është pranuar kërkesa e saj për rishikim, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar. Ajo e ka përmbushur edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive* në dispozicion, të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, për të cilin nuk ka mjete të tjera në dispozicion. Po kështu, kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kundërshton vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 12.2.2025 dhe ankimin kushtetues individual e ka paraqitur fillimisht në datën 2.6.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae* kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektet e *së drejtës për gjykim të paanshëm*, *aksesit në gjykatë* dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës.

17. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme,* kërkuesja ka parashtruar se gjyqtari relator i çështjes në Gjykatën e Lartë ka marrë pjesë në dhënien e vendimit nr. 2040/2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë për një

mosmarrëveshje me të njëjtat palë ndërgjyqëse dhe për të njëjtin shkak konflikti pronësie. Sipas kërkueses, kërkimet e atij vendimi në thelb janë rrjedhojë e vendimit nr. 602/2002, që është kërkuar të rishikohej prej saj dhe gjyqtari në fjalë jo vetëm është shprehur për të, por edhe e ka analizuar në favor të palës tjetër, ndaj nuk mund të dispononte në favor të saj, pasi do të dilte në kundërshtim me analizën e vendimit të tij të dhënë më parë.

18. Subjekti i interesuar, Nexhmi Allmuça, ka parashtruar se shprehet në emër të të gjithë trungjeve të bashkëpronësisë, por pa paraqitur ndonjë akt të vlefshëm përfaqësimi prej tyre, ndaj Gjykata, këtu e në vijim, do t'i konsiderojë prapësimet e paraqitura vetëm për mbrojtjen e tij. Lidhur me pretendimin në fjalë, ai ka prapësuar se relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka dhënë vendimin që kërkohet të rishikohet dhe, për më tepër, gjyqtari ka qenë në padijeni të plotë të këtij vendimi.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se paanshmëria duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, *testin subjektiv*, në kuptim të të cilit paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta dhe *testin objektiv*, se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë *(shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në vendime gjyqësore për rrethana të ndryshme të një mosmarrëveshjeje nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme *(shih vendimin nr. 6, datë 2.3.2018; nr. 22, datë 20.5.2013, të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Mbi bazën e këtyre standardeve, Gjykata vëren se gjykata e apelit në vitin 2011 ka marrë në shqyrtim çështjen me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes së pasurisë së dytë dhe kthimin e pjesëve takuese bashkëpronarëve të tjerë. Një prej gjyqtarëve të asaj gjykate ka marrë pjesë në vitin 2025, në cilësinë e relatorit, në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë (vendimi i kundërshtuar) për mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimeve gjyqësore të disponuara në procesin gjyqësor me objekt njohjen e së drejtës së bashkëpronësisë dhe kthimin e pasurisë trashëgimore. Nuk rezulton që kërkuesja të ketë kërkuar përjashtimin e atij gjyqtari nga procesi i rishikimit, ndonëse ka pasur dijeni për planifikimin e seancës në Gjykatën e Lartë, madje i është drejtuar me shkrim dy herë gjyqtarit relator me parashtrime për kërkesën për rishikim.

21. Në analizë të këtyre fakteve, Gjykata konstaton se dy proceset gjyqësore, në të cilat ka marrë pjesë gjyqtari, kanë pasur objekte të ndryshme dhe u kanë dhënë zgjidhje çështjeve të ndryshme faktike dhe juridike. Vendimi i gjykatës së apelit i vitit 2011 është dhënë në procesin gjyqësor që ka vendosur pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes së pasurisë trashëgimore dhe mbrojtjen e së drejtës së pronësisë të fituar me trashëgim, ndërsa vendimi i Gjykatës së Lartë i vitit 2025 është dhënë në procesin gjyqësor që ka përcaktuar nëse kishte prova të reja për të rishikuar vendimet gjyqësore që kishin vendosur të drejtën e bashkëpronësisë të fituar nga trashëgimia. Në këtë situatë, Gjykata çmon se fakti i paraqitur nga kërkuesja nuk vë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit relator në Gjykatën e Lartë, ndaj vlen prezumimi i paanësisë së tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

22. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë* kërkuesja ka argumentuar, ndër të tjera, se Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë dëgjimore me praninë e palëve, duke u dhënë atyre mundësi për t'u dëgjuar në zbatim edhe të parimit të kontradiktoritetit.

23. Gjykata çmon se këto argumente nuk qëndrojnë, pasi: *së pari,* Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga kërkesa për rishikim e paraqitur nga vetë kërkuesja; *së dyti,* mënyra e zhvillimit të seancës gjyqësore mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar, përkundrazi, në këto raste debati i palëve realizohet njësoj, pavarësisht formës së paraqitjes së argumenteve me shkrim, pra përmes shkëmbimit respektiv dhe në kohën e duhur të parashtrimeve, prapësimeve dhe provave dokumentare të paraqitura *(shih vendimet nr. 26, datë 9.4.2024; nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 41, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*; *së treti,* kërkuesja ka kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës së Lartë për herë të tretë për të njëjtën çështje, ndërkohë që rezulton se ajo ka qenë pjesëmarrëse aktive në të gjitha gjykimet që janë zhvilluar për çështjen në fjalë, si përfaqësuese e trashëgimlënësit të saj, ndaj ka pasur mundësinë për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

24. Përveç pretendimeve dhe argumenteve të mësipërme, kërkuesja ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektet e standardit të arsyetimit të vendimit dhe të aksesit në gjykim. Sipas saj, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë rëndësinë e provave të reja shkresore të siguruara nga Arkivi Qendror Shtetëror, të cilat nuk janë përdorur asnjëherë në gjykimet e mëparshme dhe nuk diheshin prej saj, pasi fondi në të cilin ato gjenden është përpunuar dhe pasuruar në vazhdimësi në një periudhë të mëvonshme. Gjykata vlerëson se këto pretendime janë me natyrë kushtetuese dhe hyjnë në juridiksionin e saj, ndaj, mbështetur në thelbin e tyre, do t'i analizojë ato në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykim

25. Kërkuesja ka pretenduar se ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit në datën 15.12.2015 dhe ka zbuluar tri dokumente: (i. fotokopje të regjistrit (Libri Themeluer i Çashtjeve Civile – Gjykatës së Paqtimit (D.C) të Gjykatës së Diktimit të vitit 1944; ii. fotokopje të faqes të regjistrit të Seksionit të Statistikës pranë Ministrisë së Financave të viteve 1944-1945; iii. fotokopje të regjistrit të Kadastrës së Rrethit të Tiranës. Sipas kërkueses, këto akte kanë rëndësi për çështjen dhe nuk mund të diheshin gjatë shqyrtimit të saj, pasi ato janë nxjerrë nga Arkivi Qendror Shtetëror, i cili ka pasur vështirësi në gjetjen e tyre më parë. Kjo për shkak se në vitet 2000–2001, kohë kur ka filluar gjykimi, nuk ishte bërë inventarizimi, indeksimi, regjistrimi dhe kompjuterizimi i dokumenteve dhe se një pjesë e dokumenteve kanë ardhur më vonë në këtë institucion. Po kështu, shprehet kërkuesja, këto prova po të diheshin më përpara, vendimi i gjykatës do të ishte i ndryshëm. Shprehja se ajo "nuk ka treguar diligjencën e duhur" në gjetjen e provave është e pavend, pasi provat shkresore të siguruara nga Arkivi Qendror Shtetëror nuk diheshin prej saj.

26. Subjekti i interesuar, Nexhmi Allmuça, ka prapësuar se tri provat e reja janë të ngjashme me dhjetëra prova të nxjerra nga Arkivi Qendror Shtetëror, të depozituara nga palët ndërgjyqëse në dosjen gjyqësore. Po kështu, sipas këtij subjekti, kërkuesja ka bërë kërkesa të përsëritura për rishikimin e vendimit për të njëjtën çështje dhe për të njëjtin shkak që lidhet me gjetjen e tri "provave të reja", të cilat nuk kanë asnjë rëndësi juridike dhe provuese, sepse nuk ndikojnë në ndryshimin e fakteve. Ajo ka shtrembëruar faktet, pasi aktet e pretenduara prej saj nuk kanë asnjë lidhje me çështjen dhe nuk vërtetojnë origjinën e pronës në favor të kërkueses, përkundrazi vërtetojnë të kundërtën e asaj që ajo pretendon, se babai i saj ka regjistruar pronën e të atit në emrin e tij.

27. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Kadastrës Tiranë, ka vënë në dispozicion aktet e administruara përfshirë inventarin e brendshëm të dosjes ku gjenden aktet që i përkasin pronës së kërkueses. Kurse subjekti tjetër i interesuar, Drejtoria e Administrimit të Tokës, është shprehur se për realizimin e funksionit si kadastër e shumëqëllimshme mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues, pavarësisht nga koha e krijimit, dokumente në të cilat evidentohen pronësitë, private ose shtetërore (publike), të periudhës përpara hyrjes në fuqi të ligjit për reformën agrare të vitit 1945 dhe se veprimet e institucionit janë kryer në mbështetje të ligjit dhe dokumentacionit ekzistues.

28. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 33, datë 30.5.2023; nr. 11, datë 10.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata është shprehur se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim *(shih vendimin nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Po kështu, Gjykata ka pranuar se e drejta e aksesit ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit ose të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit *(shih*

vendimet nr. 70, datë 24.11.2016; nr. 10, datë 4.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese).

30. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse *(shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

31. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet duke analizuar nëse arsyetimi i Gjykatës së Lartë për zbatimin e ligjit procedural për aktet e paraqitura nga kërkuesja është i qartë në atë masë sa të ketë respektuar edhe të drejtën e aksesit në gjykim të saj.

32. Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore, me argumentin se me shkresën e datës 15.12.2015 Arkivi Qendror Shtetëror, në përgjigje të kërkesës së saj, i ka dërguar tri materiale. Këto materiale janë konsideruar prej saj si "prova të reja" që ndikonin në thelbin e çështjes dhe konkretisht: i. fotokopje të regjistrit të Librit Themeluer i Çashtjeve Civile - Gjykatës së Diktimit (D.C.), të vitit 1944, sipas të cilit në datën 3.4.1944 është regjistruar padia e shtetases H.M., e veja e S.M. për vehte dhe për të miturit e saj kundër Inspektoria e Arsimit dhe Bashkia e Kryeqytetit së qytetit të Tiranës dhe në kolonën për shkurtimin e gjykimit pasqyrohet shënimi i aktgjykimit të Gjykatës së Paqtimit të Tiranës me nr. 117, datë 28.3.1944, që përmban refuzimin e padisë për ndalimin e të paditurve që të nxjerrin forcërisht nga shtëpia ku banojnë paditësat; ii. fotokopje të regjistrit të Kadastrës së Rrethit të Tiranës të vitit 1956, që përmban të dhëna për pronat e ndodhura në lagjen "Ali Demi" dhe në Qendër Shkozë; iii. fotokopje të faqes të regjistrit të Seksionit të Statistikës pranë Ministrisë së Financave të vitit 1945, sipas së cilës është regjistruar sipërfaqja e tokës dhe prodhimi i të lashtave në vitet bujqësore 1944–1945, në të cilin gjendet i pasqyruar edhe emri i H.M.

33. Gjatë kohës që kërkesa ishte në pritje për shqyrtim, në datën 27.6.2024 kërkuesja ka vënë në dispozicion të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, shkresën e datës 11.5.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila, në përgjigje të kërkesës së saj, bënte me dije se përgjigjet nga ky institucion bazohen në varësi të plotësimit të formularit të aplikimit, pronarit për të cilin janë kërkuar të dhëna, periudhës kohore, vendndodhjes së pronës, si dhe dokumentacionit bashkëngjitur. Po sipas kësaj shkrese, lidhur me pyetjen e kërkueses se pse këto dokumente nuk ishin siguruar në të njëjtën kohë, ai institucion bën me dije se në bazë të nenit 17 të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", të ndryshuar *(Ligji për Arkivat),* Arkivi Qendror Shtetëror ruan, përpunon, administron dhe shërben dokumente dhe në këtë mënyrë ky institucion pasurohet vazhdimisht me dokumente dhe të dhëna të reja të cilat evidentohen në databazën e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

34. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar kërkesën për rishikim, mbështetur në përmbajtjen e nenit 494, shkronja "a", të KPC-së, ka vlerësuar se ajo nuk plotësonte shkaqet për pranimin e saj. Sipas saj, ndonëse provat të cilave u referohej kërkuesja plotësonin standardin e të qenit prova me shkresë, ato nuk mund të konsideroheshin si prova të zbuluara rishtazi dhe që nuk mund të diheshin më parë, pasi dokumentet arkivore janë prova të cilat ajo (kërkuesja) ka pasur mundësitë për t'i gjetur gjatë gjykimit, mjafton të tregonte diligjencën e duhur dhe t'u drejtohej me kërkesë institucioneve përkatëse. Dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesja, pavarësisht se kur është nxjerrë nga arkivi qendror, ka ekzistuar gjatë gjykimit (madje gjykata ka administruar disa dokumente arkivore) dhe ajo nuk ka pasur asnjë pengesë objektive për të paraqitur këto dokumente. Nga ana tjetër, ka arsyetuar Gjykata e Lartë, lidhur me rëndësinë e këtyre provave në raport me vendimmarrjen e gjykatave, ato nuk rezultojnë se paraqesin të dhëna fikse që ndikojnë drejtpërdrejt në ndryshimin e fakteve mbi të cilat është mbështetur vendimi i formës së prerë që kërkohet të rishikohet, por është kërkuesja e cila pretendon t'i japë një mënyrë të tillë vlerësimi këtyre të dhënave, duke synuar ndikimin në vendimin e formës së prerë. Sipas Gjykatës së Lartë, në vendimmarrjen e saj gjykata e apelit ka argumentuar mbi rëndësinë e të dhënave të regjistrave të pronësisë së tokës, pas daljes së ligjit për reformën

agrare, të cilat nuk mund të vërtetojnë origjinën e pronës *(shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

35. Gjykata, në konsideratë të sa më sipër, çmon të vërë në dukje përmbajtjen e nenit 17 të Ligjit për Arkivat, sipas të cilit Arkivi Qendror Shtetëror ruan, përpunon, administron: a) dokumentet që janë trashëguar nga shteti shqiptar nga periudha parashtetërore; b) dokumentet që janë krijuar nga autoritetet publike deri në vitin 1944; c) dokumentet që janë krijuar nga organet partiake deri në vitin 1991; ç) dokumentet që janë krijuar nga autoritetet qendrore publike pa kufizim kohor, me përjashtim të atyre që ruhen në arkivat e sistemit, në arkivat e tjerë të përhershëm; d) dokumentet e krijuara nga autoritetet e tjera publike joqendrore pas vitit 1944, por janë të vetme në llojin e tyre; dh) dokumentet që janë krijuar prej subjekteve e personave juridikë dhe fizikë privatë, të kaluara në pronësi të shtetit para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7726, datë 29.6.1993, "Për fondin arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe për arkivat"; e) dokumentet që janë të dhuruara nga personat fizikë dhe juridikë privatë dhe që vlerësohen si dokumente me rëndësi historike kombëtare nga Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve.

36. Gjykata vëren se tri aktet e konsideruara nga kërkuesja si "prova të reja" i janë vënë asaj në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, që sikurse ka konfirmuar në përgjigjen e saj *(shih paragrafin 33 të vendimit),* databaza ku evidentohen aktet pasurohet vazhdimisht me dokumente dhe të dhëna të reja. Këto tri akte i përkasin një periudhe kohore (vitet 1944–1956) të një forme tjetër qeverisjeje dhe janë lëshuar nga Gjykata e Diktimit ose e Paqtimit, Kadastra e Rrethit të Tiranës dhe Seksioni i Statistikës pranë Ministrisë së Financave të kohës. Ndërkohë, gjykimi i çështjes në fjalë (objekt i kërkesës për rishikim) ka ndodhur në vitet 2001–2003, pra rreth 13 vjet më parë se kërkuesja të dispononte aktet nga institucioni i Arkivit Qendror Shtetëror dhe në atë kohë institucionet që kishin lëshuar aktet në fjalë kishin vite që kishin pushuar së ekzistuari. Në kërkesën e saj për rishikimin e procesit gjyqësor, kërkuesja ka pretenduar pamundësinë objektive për të vënë në dispozicion në kohën e gjykimit aktet e përcjella nga arkivi. Mirëpo Gjykata e Lartë, pasi ka analizuar kërkesën për rishikim, është shprehur se këto akte nuk mund të konsiderohen si prova të zbuluara rishtazi, që nuk mund të diheshin më parë dhe se kërkuesja ka pasur mundësitë për t'i gjetur gjatë gjykimit, duke iu drejtuar me kërkesë institucioneve përkatëse, por pa treguar se kujt institucioneve kërkuesja mund t'u drejtohej që të dispononte këto akte, duke i ngarkuar në këtë mënyrë asaj një barrë të tepruar.

37. Në analizë të këtyre rrethanave, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka marrë vetëm formalisht në shqyrtim kërkesën për rishikim, pa u kushtuar vëmendjen e duhur fakteve dhe rrethanave që nuk vareshin nga kërkuesja. Kërkesa për rishikim është bërë pikërisht për aktet e kërkuara dhe të gjetura nga kërkuesja dhe aksesimi në kohë i tyre ka qenë i kufizuar për arsye objektive që lidhen me kompleksitetin e procesit të administrimit, përpunimit dhe shërbimit të dokumenteve zyrtare të tyre nga institucionet kompetente. Po ashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të kufizuar lidhur me vlerën që aktet e reja paraqisnin në drejtim të thelbit të çështjes, duke u mjaftuar me konkluzionin se ato nuk ndryshonin rezultatin e çështjes dhe pa u ndalur të jepte shpjegime në këtë drejtim. Në këtë pikë, Gjykata thekson se në rastin e vendimeve për kërkesat për rishikim, referimi i Gjykatës së Lartë tek arsyetimi i gjykatës së apelit nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse bëhet fjalë për një referim tek arsyetimi i një vendimi gjyqësor, i cili nuk është bazuar tek aktet e reja të paraqitura nga kërkuesja. Në këtë pikëpamje, Gjykata e Lartë, e cila ka kompetencën me ligj të shqyrtojë kërkesat për rishikim, kur konstaton se formalisht aktet përbëjnë prova të reja, ka detyrimin të analizojë edhe thelbin e atyre akteve, për t'i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit nëse procesi gjyqësor përfundimtar ka pasur ose jo gabime të rënda gjyqësore.

38. Për sa më sipër, Gjykata e Lartë, në kuptim edhe të përmbajtjes së dispozitës procedurale të zbatueshme, nenit 494, shkronja "a", të KPC-së, nuk ka arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese se përse provat e reja të paraqitura nga kërkuesja nuk janë nga ato që parashikon kjo dispozitë dhe sesi mundej që kërkuesja t'i kishte siguruar ato në kohën e duhur, duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të saj.

39. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesja nuk plotëson mjaftueshëm kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për ofrimin e garancive për proces të

rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykim, ndaj pretendimet e kërkueses për cenimin e këtyre elementeve të së drejtës kushtetuese janë të bazuara.

40. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueses janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-509, datë 12.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.3.2026.
Shpallur më 21.4. 2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Marsida Xhaferllari
Anëtarë kundër: Ilir Toska, Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Fatmira Allmuça, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-509, datë 12.2.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ne, gjyqtarët Ilir Toska dhe Asim Vokshi, jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se pretendimet janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Duke shmangur përsëritjen e fakteve dhe të rrethanave të çështjes, vëmë në dukje se gjykimi kushtetues ka për objekt vlerësimin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, që ka vendosur për herë të tretë mospranimin e kërkesës për rishikimin e dy vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Lartë, të dhëna në vitet 2002 dhe 2003, në kuadër të një procesi gjyqësor civil, në të cilin është njohur e drejta e bashkëpronësisë së trashëgimtarëve të tjerë (krahas babait të kërkueses) për pasurinë me sipërfaqe 109.000 m^2, e trajtuar si pasuri trashëgimore e ardhur nga trashëgimlënësi S.A.(M.). Kërkesën e tretë për rishikimin e vendimeve gjyqësore kërkuesja e ka mbështetur në tri dokumente të gjetura në Arkivin Qendror Shtetëror, të cilat, sipas saj, provonin pronësinë vetëm të babait të saj për pronën në fjalë. Për gjetjen e këtyre akteve kërkuesja ka paraqitur edhe një përgjigje të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (shkresa nr. 4677/1 prot., datë 11.5.2023), sipas së cilës *databaza* e këtij institucioni pasurohet vazhdimisht me dokumente dhe të dhëna të reja. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkueses për rishikimin e vendimeve gjyqësore dhe kërkuesja, në vijim, ka paraqitur ankim kushtetues individual, me pretendimet se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

3. Shumica ka vlerësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar *(shih paragrafin 21 të vendimit),* ndërsa pretendimet e tjera, pasi i ka analizuar të lidhura me njëra-tjetrën, i ka çmuar si të bazuara, me arsyetimin se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk plotëson mjaftueshëm kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për ofrimin e garancive për proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me aksesin në gjykim *(shih paragrafët 24 dhe 39 të vendimit).* Konkretisht, shumica ka arsyetuar, se: i. Gjykata e Lartë ka marrë vetëm formalisht në shqyrtim kërkesën për rishikim, pa u kushtuar vëmendjen e duhur fakteve dhe rrethanave që nuk vareshin nga kërkuesja; ii. aktet e kërkuara dhe të gjetura nga kërkuesja, si dhe aksesimi në kohë

i tyre ka qenë i kufizuar për arsye objektive që lidhen me kompleksitetin e procesit të administrimit, përpunimit dhe shërbimit të dokumenteve zyrtare nga institucionet kompetente; iii. Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të kufizuar për vlerën që aktet e reja paraqisnin në drejtim të thelbit të çështjes, duke u mjaftuar me konkluzionin se ato nuk ndryshonin rezultatin e çështjes dhe pa u ndalur të jepte shpjegime në këtë drejtim; iv. referimi i Gjykatës së Lartë tek arsyetimi i gjykatës së apelit nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse bëhet fjalë për një referim tek arsyetimi i një vendimi gjyqësor, i cili nuk është bazuar tek aktet e reja të paraqitura nga kërkuesja; (v) Gjykata e Lartë ka kompetencën dhe detyrimin të analizojë edhe thelbin e atyre akteve që përbëjnë prova të reja, për t'i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit nëse procesi gjyqësor përfundimtar ka pasur ose jo gabime të rënda gjyqësore; vi, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë ezauruese se përse provat e reja të paraqitura nga kërkuesja nuk janë nga ato që parashikon kjo dispozitë dhe sesi mundej që kërkuesja t'i kishte siguruar ato në kohën e duhur, duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të saj *(shih paragrafët 37 dhe 38 të vendimit)*.

4. Ndonëse bashkohemi me qëndrimin e shumicës për sa i takon pabazueshmërisë së pretendimit të kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme, nuk ndajmë të njëjtin vlerësim lidhur me argumentet se Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrimet e saj kushtetuese dhe ligjore në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit. Në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë jo vetëm ka marrë në shqyrtim aktet e paraqitura nga kërkuesja si prova të reja, por edhe i ka dhënë përgjigje se përse ato nuk përmbushnin kriteret e pranueshmërisë së kërkesës për rishikim sipas përcaktimeve të nenit 494 të KPC-së.

5. Kjo dispozitë procedurale parashikon rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë edhe në rastin kur zbulohen rrethana të reja ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj *(shkronja "a")*. Në analizë të përmbajtjes së kësaj dispozite, Gjykata e Lartë ka evidentuar se instituti i rishikimit të vendimit gjyqësor civil është një mjet jo i zakonshëm për të kundërshtuar një vendim gjyqësor civil të formës së prerë, i cili mund të kërkohet vetëm nëse ekzistojnë shkaqet e përmendura në mënyrë shteruese në nenin 494 të KPC-së. Sipas saj, kuptimi i kërkesës për rishikim në të drejtën procedurale civile është elaboruar edhe nga Gjykata, e cila, në vendimin nr. 66, datë 31.5.2013, është shprehur se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Po kështu, argumenton Gjykata e Lartë, kërkesa për rishikim duhet detyrimisht të përmbajë shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse, ditën e zbulimit ose të vërtetimit të rrethanës, apo marrjes së dokumenteve. Për kërkesën për rishikim vendoset mospranimi nëse përmbushet një nga këto kushte: së pari, është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 të KPC-së; së dyti, është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë; së treti, rezulton haptazi e pambështetur *(shih paragrafët 13–15 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

6. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë ka konstatuar se, si shkak për kërkesën për rishikim, kërkuesja ka pretenduar zbulimin e provave të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj, duke paraqitur për këtë qëllim aktet, si vijon: 1. fotokopje e dokumentit "Libri Themeluer i Çashtjeve Civile – Gjykatës së Paqtimit (D.C) të Gjykatës së Diktimit" i vitit 1944, në të cilin, me nr. rendor 75, datë 3.4.1944, është shënimi se në datën 3.4.1944 është regjistruar padia e shtetases H.M., e veja e S.M.(A.) kundër Bashkisë së qytetit të Tiranës, me anën e së cilës i kërkon gjykatës që të ndalojë të paditurit që ta nxjerrin forcërisht nga shtëpia atë dhe fëmijët e saj; 2. fotokopje e dokumentit "Regjistër" i Seksionit të Statistikës pranë Ministrisë së Financave i viteve 1944–1945, në të cilin ka shënime për tokat dhe pronarët, të ndara në zëra kadastralë, për efekt të llogaritjes dhe pagimit të taksave për vitet bujqësore 1944–1945; 3. fotokopje e dokumentit "Regjistër" i Kadastrës së Rrethit të Tiranës, në të cilin ka të dhëna për pronat e pronarëve në vitin 1956. Sipas kërkueses, këto akte shkresore përfaqësojnë prova që nuk janë përdorur në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi për të cilin kërkohej rishikimi. Po sipas saj, aktet janë siguruar nga Arkivi Qendror Shtetëror, kështu që nuk mund të dihej ekzistenca e tyre, madje edhe për vetë arkivin

ka qenë e vështirë gjetja e tyre më parë, për arsye se në vitet 2000-2001, kohë kur ka filluar gjykimi, nuk ishte bërë inventarizimi, indeksimi, regjistrimi dhe kompjuterizimi i dokumenteve. Përveç kësaj, një pjesë e dokumenteve arkivore kanë ardhur më vonë në këtë institucion. Për rrjedhojë, sipas kërkueses, aktet në fjalë përbënin prova të reja. Gjithashtu, sipas saj, këto prova të reja kanë rëndësi thelbësore për çështjen, aq sa, po të diheshin më përpara, vendimi i gjykatës do të ishte ndryshe dhe jo ky që është sot (*shih paragrafët 8 dhe 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

7. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se, në kuptim të nenit 494 të KPC-së, një ndër shkaqet për të cilat pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë përfshin zbulimin e rrethanave të reja ose të provave të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj. Për t'u vërtetuar ky shkak rishikimi duhet, që: *i. të zbulohen rrethana të reja ose prova të reja me shkresë; ii. rrethanat ose provat e zbuluara rishtazi të kenë rëndësi për çështjen; iii. ato nuk mund të diheshin dhe as të kishte mundësi të diheshin gjatë shqyrtimit të çështjes.* Sipas saj, padijenia e këtyre provave ose rrethanave gjatë gjykimit mund të ketë ardhur si për faj të palës kundërshtare që ka vepruar në keqbesim, ashtu edhe për çdo shkak tjetër që nuk rrjedh nga faji i palës që paraqet kërkesën. Në rastin e provës, ajo duhet të jetë patjetër shkresore për t'u marrë në konsideratë. Dëshmitë e dëshmitarëve ose çdo lloj prove tjetër joshkresore, sado e rëndësishme për zbulimin e së vërtetës objektive, nuk mund të jenë shkak për pranimin nga gjykata të kërkesës për rishikim. Po kështu, Gjykata e Lartë ka theksuar se kërkesa për rishikim nuk mund të pranohet edhe kur pala e interesuar ka pasur mundësi ta sigurojë provën gjatë gjykimit në shkallë të parë ose edhe gjatë gjykimit në apel, përpara se vendimi të marrë formë të prerë. Që prova ose rrethana të merren në konsideratë për të pranuar kërkesën për rishikim, ato duhet të jenë të tilla që nuk diheshin dhe nuk mund të diheshin nga kërkuesi gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatë dhe të jenë zbuluar rishtazi. Për më tepër, për t'u pranuar kërkesa për rishikim, prova shkresore ose rrethana duhet të jetë thelbësore për zgjidhjen e çështjes, duhet të ketë lidhje me themelin e padisë dhe të ketë ndikuar në marrjen e vendimit. Gjithashtu, nuk përbën rrethanë të re as rrethana që nuk ekzistonte në kohën e gjykimit të çështjes, por që u vërtetua më vonë, ose rrethana që, në kohën e zhvillimit të gjykimit, ekzistonte në një formë të caktuar e që u ndryshua pasi vendimi mori formë të prerë *(shih paragrafët 18–20 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

8. Në analizë të këtyre kërkesave të ligjit, për sa i përket kërkesës për rishikim të kërkueses, Gjykata e Lartë, fillimisht, ka arsyetuar se, në rastin konkret, provat të cilave u referohet kërkuesja plotësojnë standardin e të qenit prova me shkresë, por nuk mund të konsiderohen si prova të zbuluara rishtazi dhe që nuk mund të diheshin më parë. Dokumentet arkivore të paraqitura nga kërkuesja janë prova të cilat kjo e fundit ka pasur mundësi t'i gjente, mjafton të kishte treguar diligjencën e duhur gjatë gjykimit duke iu drejtuar me kërkesë institucioneve përkatëse. Ato dokumente, pavarësisht se kur janë nxjerrë nga AQSH-ja, kanë ekzistuar gjatë gjykimit (madje gjykata ka administruar disa dokumente arkivore) dhe pala nuk ka pasur asnjë pengesë objektive për të paraqitur këto dokumente *(shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

9. Pavarësisht këtij përfundimi, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar në vijim edhe kërkesën e ligjit në drejtim të rëndësisë së provave të reja për çështjen, pra në raport me vendimmarrjen e gjykatave, duke arritur në përfundimin se ato nuk paraqesin të dhëna fikse, të cilat të ndikonin drejtpërdrejt në ndryshimin e fakteve mbi të cilat është mbështetur vendimi i formës së prerë që kërkohet të rishikohet. Sipas saj, nëse këto dokumente arkivore do të përmbanin të dhëna të cilat mohonin një fakt të caktuar të pranuar si të provuar nga gjykatat, atëherë ato do të mund të vlerësoheshin si të afta për të bazuar kërkesën për rishikim. Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimmarrjen e saj, ka argumentuar për rëndësinë e të dhënave të regjistrave të pronësisë së tokës, pas daljes së ligjit për reformën agrare, të cilat, sipas saj, nuk mund të vërtetojnë origjinën e pronës *(shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

10. Në lidhje me këtë përfundim, Gjykata e Lartë, fillimisht, ka parashtruar arsyetimin e përmbledhur të Gjykatës së Apelit Tiranë në vendimin për të cilin kërkohej rishikimi. Konkretisht, Gjykata e Lartë ka evidentuar se Gjykata e Apelit Tiranë, ndër të tjera, ka arsyetuar se:

"[...] në seancë janë administruar një sërë dokumentesh pronësie që vërtetojnë pronësinë në emër të S.A. (shih vërtetimin e hipotekës Tiranë me nr. 145, datë 19.3.1931). Edhe dokumentet e tjera që vërtetojnë pronësinë e familjes Allmuça, përpara

vitit 1945 janë në emër të S.A.(M.). I vetmi regjistrim në emër të të padituri është ai i vitit 1946, në kohën e Reformës Agrare. I padituri, duke qenë fëmija i madh i familjes dhe administratori i pasurisë pas vdekjes së babait dhe nënës, ka përfaqësuar këtë familje në marrëdhënie me të tretët dhe shtetin. Kështu del se, në këtë kohë, janë regjistruar në emër të tij 136 dynymë tokë dhe disa rrënjë ullinj. Nga kjo tokë i janë marrë nga Reforma Agrare rreth 70 dynymë tokë. I padituri këtë regjistrim të pasurisë në vitin 1946 në emër të tij do ta paraqesë si pronë të tij që ia ka dhuruar babai i tij që në vitin 1937. Por këtë fakt ai nuk e shoqëron me asnjë provë tjetër veç pohimit të tij.

Nuk mund të pranohet pretendimi i të padituri për aktin e dhurimit kur për të nuk ka kontratë dhurimi, si një akt i domosdoshëm për kalimin e pronësisë së paluajtshme, ose ky akt të ekzistonte i regjistruar në regjistrin e pronësisë të përpara Çlirimit, të cilat janë të plota. Në regjistrimin që i ka bërë pronës në vitin 1946 në emër të tij i padituri nuk e ka shoqëruar me burimin e fitimit të saj. Ai, në një kërkesë që i ka bërë Ministrisë Bujqësisë më 16.10.1964, i lutet kësaj ministrie për të hequr nga shpronësimin një pjesë të tokës, pasi nuk kishte më se të mbante familjen. Ai thotë: *"...toka, si këto dhe të tjera të dorëzuara, i kam trashëguar prej atit tonë S.A., e që ndodhen në Katundin Shkozë të rrethit të Tiranës. Nuk kam trashëguar vetëm tokën..."*. Pra, edhe në organet shtetërore të kohës, i padituri është prezantuar si trashëgimtar, jo si pronar i tokës.

Pretendimi tjetër i të padituri se ai ka qenë familje më vete përpara vitit 1945, nuk është i vërtetë. Nga aktet e gjendjes civile del se i padituri ka qenë në një trung me babanë e tij edhe në regjistrimin e bërë në vitin 1945. Më 25.8.1945 të padituri i ka lindur fëmija L.A. dhe e ka regjistruar në trungun e babait. Nuk del asnjë regjistrim i pronës në emër të tij përpara daljes së ligjit nr. 108, datë 29.8.1945, "Për reformën agrare". Përpara kësaj date, të gjitha pronat ekzistojnë në emër të babait të tyre. Pra, vetëm shënimet në regjistrat e pronësisë së tokës, pas daljes së ligjit për reformën agrare, nuk mund të vërtetojnë origjinën e pronës. Këto shënime janë sipas deklarimeve në komisionet e ngritura në kohë. Në këto regjistra nuk del origjina e pronës. I padituri, duke qenë fëmija i madh i familjes "Allmuça", pasi paditësi I. ishte 13 vjeç dhe paditësja R. 8 vjeç, kurse dy motrat e tjera ishin martuar, ka disponuar në emër të tij pronat e trashëguara nga babai.

Paditësit në gjykim kanë vërtetuar origjinën e pronës, kanë vërtetuar se trashëgimlënësi i tyre nuk ka dhuruar pronën në gjallërinë e tij, nuk ka lënë testament përpara vdekjes. Pra, kanë vërtetuar se prona është e gjitha e babait të tyre dhe, si e tillë, është pasuri trashëgimore që e trashëgojnë të gjithë fëmijët e S.A. nga 1/5 pjesë. I padituri, me vendimin nr. 254, datë 15.1.1995, ka vërtetuar kufijtë e pronës që ai ka pretenduar si të tijën. Por, nga aktet del se pikërisht pronarët që pretendojnë se kufizohen me H.A. (të padituri) në aktet e pronësisë së tyre kufizohen me pronat e S.A., babait të palëve. Kështu, prona e Teqes Bektashiane kufizohet me S.M.(A.) dhe jo me H. Po kështu, B.A. kufizohet me S.A. dhe jo me H. Pra, ky vendim, që i padituri e ka paraqitur si provë, vërteton të kundërtën e pretendimit të tij.

Praktika gjyqësore ka konfirmuar në zgjidhjet e saj se nuk mund të njihet pronar i një sipërfaqeje toke ose trualli një person me vërtetim fakti ose vetëm me regjistrime pas vitit 1946, pa u treguar burimi i pronës (me blerje ose me dhurim). Në rastin konkret, sipas akteve, kjo pronë ka vetëm një origjinë, si pronar i saj nga viti 1931 ka qenë babai i palëve S.A. Ai nuk ka bërë kalim të pronësisë deri sa ka vdekur në vitin 1943, veç një sipërfaqe toke që ia ka shitur Komunitetit Mysliman Bektashian, më 21.6.1939, një sipërfaqe prej 24 dynymësh. Pikërisht në këtë sipërfaqe që ka ngelur pa u shitur pretendon se është pronar i padituri. Pra, përfundimisht, padia e paditësve për t'u njohur si pasuri trashëgimore që u vjen palëve nga babai i tyre duhej të pranohej. Vendimi i gjykatës duhet të ndryshohet dhe të pranohet padia.

Në këtë gjykim paditësit kanë vërtetuar se janë trashëgimtarë të S.A. dhe se e gjithë prona që ka disponuar i padituri është pasuri trashëgimore. Pra, ata në këtë gjykim kanë fituar legjitimitetin për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë trashëgimore ose disponimin e saj, sipas marrëveshjes së bashkëpronësisë *(shih paragrafin 6 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

11. Për sa më lart, jemi të mendimit se, përkundër asaj që ka vlerësuar shumica, Gjykata e Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm për arsyet e mospranimit të kërkesës së kërkueses për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ajo ka dhënë argumente ligjore se përse aktet shkresore të paraqitura nga

kërkuesja nuk plotësonin kriteret e kërkuara nga neni 494 i KPC-së. Sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, kërkuesja kërkon të rishikojë një proces gjyqësor që është përmbyllur me vendim përfundimtar që në vitin 2003, çka do të thotë se ajo ka pasur në dispozicion një kohë më se të mjaftueshme për të gjetur dhe për të paraqitur aktet në fjalë. Sikurse rezulton nga shqyrtimi i çështjes, aktet kanë qenë pjesë e arkivave të institucioneve publike dhe, më pas, pjesë e Arkivit Qendror, çka tregon se ato kanë ekzistuar edhe në kohën e gjykimit të çështjes dhe mundësia që kërkuesja t'i paraqiste në kohë ka qenë e realizueshme dhe nuk ka qenë e kufizuar në mënyrë objektive. Nga ana tjetër, pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka argumentuar edhe në drejtim të vlerës provuese dhe rëndësisë së tyre për çështjen, duke arritur në përfundimin se aktet shkresore të paraqitura nga kërkuesja si prova të reja nuk janë të afta për të hedhur poshtë faktet e pranuara në vendimin gjyqësor të formës së prerë, pra se ato nuk mund të ndryshonin rezultatin e çështjes.

12. Mbështetur në këto konsiderata, vlerësojmë se kërkueses, efektivisht, i është krijuar mundësia të paraqesë prova, fakte dhe argumente për çështjen në gjykim, duke iu siguruar kështu e drejta e aksesit në mënyrë efektive. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë jo vetëm që ka disponuar në lidhje me kërkesën e kërkueses për rishikim, por ka shqyrtuar dhe arsyetuar, duke i dhënë përgjigje të argumentuar shkakut të rishikimit të pretenduar nga kërkuesja. Gjykata e Lartë nuk është mjaftuar vetëm me një trajtim formal të çështjes, por, përkundrazi, ka shqyrtuar provat e paraqitura në funksion të vërtetimit të rastit të rishikimit, si dhe analizën e tyre në raport me ligjin e zbatueshëm, ndërkohë që përfundimet e arritura mbështesin qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Në këto rrethana, nuk rezulton që ajo të ketë refuzuar të drejtën e aksesit në gjykim, por përkundrazi të ketë ushtruar funksionin e saj kushtetues e ligjor për të verifikuar nëse ishin përmbushur kushtet për përdorimin e një mjeti të jashtëzakonshëm kundër një vendimi të formës së prerë. Për më tepër, në vlerësimin tonë, argumentet e parashtruara nga kërkuesja kanë të bëjnë në thelb me çështje të natyrës ligjore, analiza e të cilave bën pjesë në kompetencën funksionale të Gjykatës së Lartë si gjykatë e ligjit, e cila duket se e ka përmbushur në mënyrën e duhur ligjore dhe faktike këtë funksion.

13. Është e rëndësishme të theksohet se, në gjykimet e kërkesave për rishikim, kërkuesi duhet të provojë jo vetëm se ka zbuluar një ose disa prova të reja, por edhe se, ndonëse ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme dhe të mundshme gjatë gjykimit të çështjes në themel, për t'i gjetur ato, kjo ka qenë e pamundur për shkaqe të pavarura nga vullneti ose diligjenca e tij. Po kështu, vetëm fakti i zbulimit të provave të reja me shkresë është i pamjaftueshëm për të vënë në diskutim drejtësinë e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nëse ato prova, në pikëpamje të rëndësisë së të dhënave që ofrojnë, nuk tregojnë në mënyrë të qartë se faktet e pranuara në atë vendim janë të ndryshme, pra se vendimi, në thelb, është i padrejtë. Kjo për shkak se rishikimi prek gjënë e gjykuar dhe, për rrjedhojë, vetë parimin e sigurisë juridike, çka imponon që kushtet për përdorimin e këtij instituti procedural të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë rigoroze. Në të njëjtën frymë, edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së ka theksuar se e drejta për një gjykim të drejtë sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, interpretuar sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike, përfshin kërkesën se, në rastin kur gjykatat kanë marrë vendim të formës së prerë për një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pyetje. Sipas këtij parimi, asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë dhe detyrues thjesht me qëllimin për të pasur një seancë gjyqësore dhe një vendim të ri për çështjen. Shqyrtimi nuk duhet të kthehet në një ankesë nën maskim. Parimi i sigurisë juridike dikton se, në rastin kur një mosmarrëveshje civile shqyrtohet për meritat nga gjykatat, vendimi duhet të merret një herë dhe përgjithmonë, dhe një distancim nga ky parim justifikohet vetëm kur është e nevojshme nga rrethanat me një karakter thelbësor dhe detyrues, të tilla, si, korrigjimi i defekteve themelore ose dështimi i drejtësisë *(shih Gaba kundër Shqipërisë, datë 17.12.2024, §§ 75-76; Ryabykh kundër Rusisë, datë 24.7.2003, § 52; Brumărescu kundër Rumanisë [DHM], datë 28.10.1999, § 61).*

14. Në përfundim, çmojmë se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë i përmbush kriteret kushtetuese në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykim, si dhe sepse një qasje më pak rigoroze ndaj kushteve të nenit 494 të KPC-së do të sillte rrezikun që rishikimi të përdorej për të vënë sërish në diskutim, pa rrethana

vërtet thelbësore e detyruese, vendime gjyqësore të formës së prerë, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Për rrjedhojë, mbajtëm qëndrimin se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtarë: Asim Vokshi, Ilir Toska

VENDIM
Nr. 221, datë 22.4.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE MBI MENAXHIMIN E INFRASTRUKTURËS DHE SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË GJYKATAT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 147, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 61, shkronja "ë", 92, pika 2, 97, pika 1, shkronja "c" dhe 98, pika 4, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar; të nenit 36, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", si dhe të VKM-së nr. 971, datë 2.12.2020, "Për miratimin e rregullave për politikat e përgjithshme shtetërore, për Sistemin e Teknologjisë së Informacionit, për Sistemin e Drejtësisë"; të VKM-së nr. 972, datë 2.12.2020, "Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë", me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë Gjyqësor

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave mbi menaxhimin e infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit në gjykatat e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe përbëjnë pjesë përbërëse të tij.

2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLAT MBI MENAXHIMIN E INFRASTRUKTURËS DHE SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË GJYKATAT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin, përdorimin, kontrollin dhe sigurimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në sistemin gjyqësor të Republikës së Shqipërisë.

2. Rregullorja synon garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit të përpunuar dhe të ruajtur në sistemet dhe bazat e të dhënave gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë përdoruesit e sistemeve TIK në gjykatat e të gjitha shkallëve të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Dispozitat e saj janë të detyrueshme për çdo person që, në bazë të funksionit, marrëdhënies së punës apo marrëdhënies kontraktore, përdor ose administron sistemet TIK.

Neni 3
Përkufizime

1. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Administrim gjyqësor" është tërësia e veprimtarive organizative dhe mbështetëse që sigurojnë funksionimin efektiv të sistemit gjyqësor;

b) "Administratori i sistemit" është personi ose grupi i personave të autorizuar për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe garantimin e sigurisë së sistemit;

c) "Akses" është e drejta e një përdoruesi për të hyrë dhe përdorur një sistem, në përputhje me detyrat e tij ose me autorizimin e dhënë;

ç) "Aksesi i autorizuar nga zotëruesi i informacionit" nënkupton qasjen në të dhëna në

përputhje me nivelin e miratuar të autorizimit, që mund të përfshijë shikimin, përpunimin, ndryshimin ose fshirjen e tyre;

d) "Aksesi i autorizuar në sistem" është procesi i krijimit dhe menaxhimit të profileve të përdoruesve dhe i të drejtave të tyre, në përputhje me politikat e sigurisë, për të garantuar akses vetëm për subjektet e autorizuara;

dh) "Autentifikim" është procesi i verifikimit të identitetit të përdoruesit përpara dhënies së aksesit në sistem;

e) "*Backup*" është infrastruktura teknike dhe proceset për krijimin dhe ruajtjen e kopjeve rezervë të të dhënave, për përdorim në raste emergjente;

ë) "*Backup* sistematik" është procesi automatik dhe periodik i kopjimit të të dhënave, me qëllim garantimin e mbrojtjes së tyre në rast humbjeje ose dëmtimi;

f) "Fjalëkalim" është kodi sekret personal që përdoret për autentifikimin e përdoruesit dhe që duhet të mbahet konfidencial;

g) "Fshirja e mediave të rishkrueshme përpara se të ripërdoren" është procesi i fshirjes ose asgjësimit të të dhënave të ruajtura në media të rishkrueshme, si disqe të ngurtë, CD ose DVD, përpara përdorimit të tyre për ruajtjen e të dhënave të reja;

gj) "Incident i sigurisë së informacionit" është çdo ngjarje që cenon ose rrezikon konfidencialitetin, integritetin ose disponueshmërinë e informacionit;

h) "Infrastrukturë e Sistemit" janë pajisjet fizike, programet, rrjetet dhe bazat e të dhënave që mbështesin funksionimin e Sistemit;

i) "Gjurmueshmëria" është procesi i kërkimit të gjurmëve/logeve, që përmbajnë informacion të nevojshëm për monitorimin dhe detektimin e veprimeve në Sistem, si dhe për zgjidhjen e problemeve të sigurisë;

j) "Hartimi i planit të vazhdimësisë së biznesit/*Disaster Recovery Plan*" është ndërmarrja e një analize për identifikimin e proceseve kryesore të punës dhe të informacionit nga i cili ato varen, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit në situata emergjente;

k) "Integriteti i të dhënave" është garantimi i saktësisë, plotësisë dhe mbrojtjes së të dhënave nga ndryshimet e paautorizuara;

l) "Kredenciale" janë të dhënat identifikuese unike që mundësojnë autentifikimin dhe aksesin në sistem;

ll) "Konfidencialiteti i të dhënave" është parimi sipas të cilit informacioni është i aksesueshëm vetëm për persona ose sisteme të autorizuara;

m) "Klasifikimi dhe inventarizimi i informacionit" është procesi i identifikimit, organizimit dhe vlerësimit të informacionit sipas rëndësisë dhe nivelit të sigurisë së kërkuar;

n) "*Malware*" janë programe ose kode me qëllim të dëmshëm që instalohen ose ekzekutohen në sistem për të shkaktuar dëme ose ndërhyrje të paautorizuara;

nj) "Masat për mbrojtjen e mjedisit" përfshijnë pajisjet dhe mekanizmat mbrojtës si sistemet kundër zjarrit, furnizimi me energji të pandërprerë (UPS) dhe mbrojtja nga dëmtimet nga uji;

o) "Mbikëqyrje" është procesi i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës dhe sistemeve TIK për garantimin e sigurisë, stabilitetit dhe performancës së tyre;

p) "Niveli i sigurisë së bazës së të dhënave të sistemit të menaxhimit" është niveli i sigurisë që aplikohet për një sistem kompjuterik të caktuar, për të garantuar mbrojtjen e tij sipas kritereve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

q) "*Off site backup*" është një metodë e sigurimit të të dhënave që përfshin kopjimin dhe ruajtjen e tyre jashtë vendndodhjes primare fizike, në një ambient të dytë;

r) "Përpunimi i të dhënave" çdo veprim i kryer mbi të dhënat, përfshirë grumbullimin, regjistrimin, ruajtjen, renditjen, përshtatjen, ndreqjen, këshillimin, shfrytëzimin, përdorimin, bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose çdo veprim tjetër, si dhe transmetimin e tyre;

rr) "Përdorues" çdo individ i identifikuar në mënyrë unike në sistem përmes një emërtimi ose kredencialeje;

s) "Përdorues i brendshëm" janë punonjësit e administratës gjyqësore dhe personat e autorizuar që aksesojnë sistemin në kuadër të funksioneve të tyre;

sh) "Përdorues i jashtëm" janë individët jashtë administratës gjyqësore që autorizohen për të aksesuar sistemin;

t) "Përditësimi automatik i të dhënave në formë elektronike" është procesi i përditësimit të të dhënave në mënyrë të automatizuar përmes mekanizmave elektronikë;

th) "Plan i Vazhdimësisë së Biznesit" – është dokumenti që përcakton procedurat për të garantuar

vazhdimësinë e aktiviteteve kritike në raste emergjente;

u) "Privilegj" është parimi sipas të cilit çdo përdorues pajiset vetëm me të drejtat minimale të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij. Zbatimi i këtij parimi kufizon dëmin që mund të rezultojë nga aksidentet, gabimet ose përdorimet e paautorizuara;

v) "Procedurat e *Backup*-it" janë procedurat e shkruara për rikuperimin e informacionit nga *backup*-i të cilat duhet të testohen periodikisht;

x) "Siguria e informacionit" është sigurimi i konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit;

xh) "Siguria kibernetike" – është tërësia e mjeteve ligjore, organizative, teknike dhe edukative, me qëllim mbrojtjen e hapësirës kibernetike;

y) "Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore" (Sistemi) janë sistemet elektronike të përdorura për administrimin e çështjeve gjyqësore, përfshirë ICMIS dhe ARKIT;

z) "Sisteme TIK" janë sistemet e teknologjisë së informacionit dhe infrastruktura përkatëse që përdoren nga gjykatat;

zh) "Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit" (TIK) janë pajisjet dhe programet elektronike që mundësojnë mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe transmetimin e të dhënave.

Neni 4
Parimet në përdorimin dhe sigurinë e infrastrukturës TIK

1. Përdorimi i infrastrukturës TIK bazohet në parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, sigurisë, profesionalizmit, saktësisë, kontrollit, llogaridhënies, barazisë dhe transparencës.

2. Mbikëqyrja dhe siguria e infrastrukturës TIK dhe e Sistemit bazohet në parimet e ligjshmërisë, unitetit dhe gjurmueshmërisë, si dhe në përdorimin automatik të të dhënave në formë elektronike.

Neni 5
Ruajtja e konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Të gjithë përdoruesit e sistemeve TIK në gjykata dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit zyrtar dhe të mbrojnë të dhënat personale të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Gjatë procedimit të çështjeve përmes sistemit, zbatohen të gjitha përgjegjësitë ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit.

3. Përdoruesit e sistemeve TIK kryejnë vetëm veprimet e nevojshme sipas autorizimeve dhe detyrave funksionale, pa tejkaluar përgjegjësitë e caktuara.

4. Çdo përdorim ose shpërndarje e paautorizuar e të dhënave konsiderohet shkelje sipas legjislacionit në fuqi.

KREU II
PËRDORUESIT, AKSESI DHE PROCEDIMI I DOSJES PËRMES SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE

Neni 6
Grupi i menaxhimit të çështjes gjyqësore (GMÇ)

1. Grupi i menaxhimit të çështjes gjyqësore përbëhet nga gjyqtari i çështjes dhe sekretari gjyqësor.

2. Grupi i menaxhimit të çështjes gjyqësore siguron përmbushjen e të gjitha hallkave të çështjes në sistem, duke përfshirë regjistrimin, përpunimin e çështjes, hedhjen e dispozitivit, pasqyrimin e vendimit dhe arkivimin elektronik të çështjes.

3. Ndihmës magjistratët dhe këshilltarët ligjorë kanë akses për hedhjen e relacioneve në Sistem.

4. Ndihmësit ligjorë kanë vetëm akses për informacion dhe vendimet e shkallëve më të ulëta.

5. Grupi i menaxhimit të çështjes gjyqësore, në zbatim të përgjegjësive të tij:

a) Siguron informacion dhe statistika për palët e interesuara, bazuar në të dhënat e ruajtura në Sistem;

b) Siguron plotësimin e të gjitha fushave të Sistemit me të dhëna të plota, të sakta dhe pa gabime. Çdo kopjim, transmetim, shpërndarje ose veprim tjetër i ngjashëm ndaj personave ose subjekteve jashtë GMÇ-së është i ndaluar;

c) Siguron mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

6. Në varësi të procesit të punës së gjykatës, një sekretar gjyqësor mund të jetë i konfiguruar në më shumë se një GMÇ.

7. Kur sekretari i caktuar në GMÇ nuk është prezent, kryhet zëvendësimi i tij në rubrikën

përkatëse për të siguruar funksionimin e GMÇ-së. Zëvendësuesit i caktohen kredenciale të veçanta me të dhënat e tij.

8. Ndalohet përdorimi i kredencialeve të sekretarit që nuk është prezent.

Neni 7

Krijimi i llogarive për përdoruesit e Sistemit

1. Çdo përdoruesi i caktohet një llogari me fjalëkalim në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve. Të drejtat e qasjes në të dhëna përcaktohen sipas autorizimeve dhe detyrave funksionale të përdoruesit.

2. Krijimi i llogarive bëhet me kërkesë, bazuar në nevojat e gjykatave.

3. Llogaritë e përdoruesve administrohen nga strukturat IT të gjykatave dhe mbikëqyren nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim garantimin e sigurisë ndaj hyrjeve të paautorizuara.

4. Fjalëkalimet duhet të përmbushin kriteret e sigurisë, sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin 29 e vijues të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Regjistrimi i çështjes përmes Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve

1. Regjistrimi fillestar i çështjes në Sistem kryhet nga sekretaria regjistruese e gjykatës.

2. Sekretaria regjistruese regjistron çështjen sipas kohës së arritjes dhe me të dhënat përkatëse të çështjes, palëve, pjesëmarrësve të tjerë dhe të dhënat e tjera të kërkuara nga Sistemi.

3. Regjistrimi i çështjeve gjyqësore kryhet në ditën e pranimit të saj, me përjashtim të rrethanave të veçanta, ai kryhet në ditën e nesërme të punës.

4. Gjatë regjistrimit të çështjes, sekretaria regjistruese:

a) Kryen verifikimin paraprak për të identifikuar çështjet e njëjta ose të ngjashme, duke marrë si referencë identitetin e palëve, objektin e çështjes, akuzën ose numrin e procedimit për rastet penale;

b) Bën kategorizimin e natyrës së çështjes, në përputhje me regjistrat fizikë në përdorim nga gjykatat;

c) Pasqyron të dhënat e palëve ndërgjyqëse dhe vendimet e mëparshme nga të gjitha shkallët e gjyqësorit, sipas fushave të kërkuara nga Sistemi;

ç) Siguron plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të çështjes gjyqësore që regjistron.

5. Çdo çështje merr numër unik identifikimi të gjeneruar nga Sistemi në secilën shkallë të gjykimit.

6. Numri i regjistrimit identifikon kategorinë e çështjes, numrin e radhës, kodin e gjykatës ku është regjistruar dhe vitin, përjashtuar Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të cilat i referohen regjistrit fizik.

7. Numri unik i identifikimit jepet vetëm një herë gjatë regjistrimit fillestar të çështjes në çdo shkallë të gjyqësorit.

8. Pas regjistrimit, të dhënat e çështjes pasqyrohen në portalin e gjykatave përkatëse.

Neni 9

Shpërndarja/rishpërndarja e çështjes gjyqësore përmes Sistemit

1. Shortimi i çështjeve kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

2. Sistemi mundëson shpërndarjen e çështjeve për gjyqtarë në mënyrë automatike dhe manuale.

3. Shpërndarja e çështjes dhe ngarkesa me numër çështjesh kryhen në bazë të kritereve të përcaktuara në aktet ligjore.

4. Funksionaliteti i shortimit të çështjeve gjyqësore menaxhohet nga kryetari i gjykatës.

5. Për çdo veprim në Sistem, arsyeja e veprimit pasqyrohet në rubrikën përkatëse.

6. Kancelari mbikëqyr procesin e organizimit dhe dokumentimit të ndarjes së çështjeve me short, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit gjyqësor gjatë përdorimit të Sistemit

1. Sekretari gjyqësor planifikon seancën në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve sipas udhëzimeve të gjyqtarit, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme për njoftimin e palëve dhe për gjenerimin e njoftimeve të seancës së planifikuar.

2. Ngarkon procesverbalin e seancës përgatitore, paraprake ose gjyqësore në Sistem.

3. Ngarkon menjëherë dispozitivin pas përfundimit të seancës në Sistem.

4. Kryen veprime të tjera në Sistem, sipas detyrave të deleguara dhe udhëzimeve të gjyqtarit përkatës, si dhe sipas akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 11
Planifikimi i seancave përmes Sistemit

1. Menjëherë pas caktimit të datës së seancës nga gjyqtari i çështjes, sekretari gjyqësor kryen të gjitha veprimet e nevojshme në Sistem për planifikimin e seancës.

2. Përmes Sistemit, sekretari gjyqësor evidenton të dhënat e seancës gjyqësore, duke përfshirë: numrin e çështjes; tipin e seancës (pajtim, dhomë këshillimi etj.); sallën e gjykimit; si dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit sipas udhëzimeve të kryetarit të seancës.

3. Çdo seancë e kryer pasqyrohet në kohë reale në Sistem.

4. Sekretari gjyqësor pasuron Sistemin me të dhëna shtesë, duke përfshirë:

a) statusin e gjykimit;

b) regjistrimin audio të seancës (po/jo);

c) zhvillimin e seancës me dyer të hapura ose të mbyllura;

ç) datën e seancës;

d) kohën e mbarimit;

dh) gjyqtarët prezent;

e) sallën e gjykimit;

ë) palët ndërgjyqëse;

f) palët e pranishme në sallë;

g) procesverbalin e seancës;

gj) arsyen e regjistrimit të vonuar (nëse ka);

h) arsyen e shtyrjes së seancës (nëse ka);

i) datën e re të planifikuar.

5. Pas regjistrimit të seancës, të dhënat e autorizuara pasqyrohen në portalin e gjykatave përkatëse sipas nivelit të tyre. Caktimi, shtyrja dhe anulimi i seancave kryhen përmes Sistemit, duke evidentuar arsyet e mosmbajtjes së seancës.

Neni 12
Regjistrimi i dispozitivit të vendimit në Sistem

1. Në përfundim të procesit gjyqësor, sekretari gjyqësor regjistron dispozitivin e çështjes në Sistem. Në ndërfaqen e regjistrimit ngarkohen të dhënat përkatëse, duke përfshirë:

a) emrin e gjyqtarit;

b) kohën e hedhjes së dispozitivit;

c) datën e dispozitivit të çështjes;

ç) palët e pranishme gjatë shpalljes së vendimit;

d) llojin e dispozitivit të vendimit;

dh) përshkrimin e dispozitivit.

2. Të dhënat e regjistruara në fushën e dispozitivit pasqyrohen në portalin e gjykatave përkatëse.

Neni 13
Regjistrimi i vendimit nga gjyqtari në Sistem

1. Të gjitha vendimet e marra nga gjyqtari rreth çështjes, qofshin vendime të ndërmjetme, përfundimtare apo jo përfundimtare, duhet të regjistrohen përmes Sistemit.

2. Hedhja e vendimeve jopërfundimtare kryhet vetëm nëse çështja ka pasur një seancë të mëparshme të regjistruar në Sistem; hedhja e vendimeve përfundimtare kryhet vetëm nëse sekretaria gjyqësore ka regjistruar dispozitivin përkatës.

3. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat e gjeneraliteteve të palëve, objektin e çështjes apo akuzën, bazën ligjore, konkluzionet e palëve, si dhe përmbajtjen e vendimit të strukturuar sipas formatit të Sistemit.

4. Të dhënat e vendimit të regjistruara pasqyrohen në portalin e gjykatave përkatëse.

Neni 14
Fshirja dhe korrigjimi i çështjes në Sistem

1. Përdoruesi që ka kryer gabime gjatë plotësimit të të dhënave ose ka ndërmarrë veprime jo të sakta gjatë realizimit të detyrave të çështjes në Sistem, të cilat nuk mund të korrigjohen nga vetë ai, duhet të adresojë kërkesën për korrigjim në mënyrë zyrtare drejtuar administratorit të sistemit përmes sistemit të raportimit të problematikave, në https://helpdesk.klgj.al.

2. Administratori i sistemit, pasi administron kërkesën, për çdo veprim që kryen në sistemin e menaxhimit të çështjeve, përfshirë fshirje ose përditësime të të dhënave, mban procesverbal në rastin kur çështja është në fazën e regjistrimit.

3. Kur çështja është shortuar, çdo veprim i kryer në sistem, qoftë fshirje apo përditësim i të dhënave,

realizohet vetëm me vendim të titullarit të institucionit.

Neni 15
Veçimi dhe bashkimi i çështjeve në Sistem

Veçimi dhe bashkimi i çështjeve gjyqësore kryhen përmes Sistemit, vetëm pasi gjyqtari i çështjes të ketë marrë vendim të ndërmjetëm përkatës.

Neni 16
Arkivimi i çështjes përmes Sistemit

1. Çështjet e përfunduara nga gjykata e nivelit përkatës, të zgjidhura me vendim të formës së prerë, arkivohen nga arkivisti, i cili ka detyrimin të regjistrojë veprimin e arkivimit në Sistem.

2. Pas arkivimit të çështjes ose të secilës dosje që i përket një numri unik, statusi i secilës dosje në atë numër unik ndryshohet në "Arkivuar". Në Sistem evidentohen vendi, data, ora dhe përdoruesi që ka kryer arkivimin e çështjes.

3. Pas përfundimit të procedurës së arkivimit, e drejta e aksesit në çështje i takon vetëm arkivistit, ndërsa për përdoruesit e tjerë të gjykatës aksesi mbyllet.

Neni 17
Aksesi në çështje sipas profilit të përdoruesit në Sistem

1. Profilet e përdoruesve në Sistem përfshijnë, por nuk kufizohen në:

a) Kryetarin e gjykatës;
b) Zëvendëskryetarin e gjykatës;
c) Gjyqtarin;
ç) Kancelarin e gjykatës;
d) Ndihmësmagjistratin;
dh) Këshilltarin ligjor;
e) Ndihmësin ligjor;
ë) Kryesekretarin;
f) Sekretarin gjyqësor;
g) Sekretarin regjistrues;
gj) Nëpunësin e financës dhe buxhetit;
h) Nëpunës të tjerë që ushtrojnë funksione në fushën e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit, si dhe marrëdhënieve me publikun dhe median;
i) Përdoruesin e gjykatës;
j) Administratorin, arkitektin ose zhvilluesin e Sistemit;
k) Inspektorin ose audituesin gjyqësor, si dhe analistin e proceseve të punës në Sistem;
l) Inspektorin e Lartë të Drejtësisë;
ll) Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Aksesi në Sistem kategorizohet si më poshtë:

a) Akses i plotë, i jep përdoruesit të drejtën për të parë të gjitha të dhënat dhe veprimet e ndërmarra në dosje, si dhe për të krijuar detyra dhe për të ndërmarrë veprime mbi çështjen;

b) Akses për lexim, i jep përdoruesit të drejtën për të parë të gjitha të dhënat, dokumentet dhe veprimet e ndërmarra në dosje, pa të drejtë për të krijuar detyra apo për të ndërmarrë veprime mbi çështjen;

c) Akses i kufizuar, i jep përdoruesit të drejtën për të parë vetëm statusin e çështjes, të dhënat e përgjithshme të rastit dhe të dhënat e palëve;

ç) Akses në të dhënat për seanca gjyqësore, i jep përdoruesit të drejtën për të parë të dhënat mbi seancat e caktuara, si: numri i dosjes, lloji i çështjes, data, ora, lloji i seancës (e hapur ose e mbyllur) dhe vendi i zhvillimit të saj;

d) Akses në çështjet e zgjidhura, përdoruesi nuk ka akses në dosjet e çështjeve në procedim, por ka të drejtë leximi në dosjet e çështjeve me status "Përfunduar";

dh) Akses në statistika;
e) Akses në regjistra;
ë) Mohim i aksesit të çështjes.

Neni 18
Raportimi përmes Sistemit

1. Raportet statistikore mbi performancën e punës së gjykatave dhe gjyqtarëve gjenerohen, për aq sa është teknikisht e mundur, përmes Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve.

2. Raportimi i problematikave që lidhen me funksionimin e Sistemit kryhet përmes platformës elektronike *Online Ticketing Service Desk*, e cila aksesohet nëpërmjet lidhjes https://helpdesk.klgj.al

KREU III
POLITIKAT DHE PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN E SISTEMEVE TIK

Neni 19
Kërkesat për mbikëqyrjen e infrastrukturës TIK

1. Infrastruktura TIK në gjykatat e Republikës së Shqipërisë dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrave funksionale, duhet të garantojë:

a) Monitorimin e rrjetit, i cili përfshin kontrollin e trafikut brenda dhe jashtë gjykatës, identifikimin e problemeve të rrjetit, si: ngadalësimi i shpejtësisë, humbja e paketave, konfliktet e adresave IP, si dhe evidentimin e përdoruesve të paautorizuar;

b) Monitorimin e serverave, që përfshin ndjekjen dhe vlerësimin e performancës së tyre, përfshirë funksionalitetin, përdorimin e burimeve, ngarkesën e CPU-së, memorien dhe ruajtjen e të dhënave;

c) Monitorimin e bazave të të dhënave, që përfshin kontrollin e performancës, vlerësimin e vonesave në kërkimin e informacionit, monitorimin e hapësirës së diskut dhe garantimin e sigurisë së tyre;

ç) Monitorimin e sigurisë, që përfshin identifikimin e aktiviteteve të paligjshme, tentativave për hyrje të paautorizuar në sistemet e gjykatës, si dhe kontrollin e aksesit të përdoruesve të autorizuar;

d) Monitorimin e pajisjeve fizike, që përfshin kontrollin e performancës së serverave, *switch*-eve, ruterëve dhe pajisjeve të tjera të rrjetit;

dh) Monitorimin e shërbimeve, duke garantuar funksionimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve IT të ofruara për përdoruesit, si: posta elektronike, shërbimet e aksesit në rrjet, aplikacionet e specializuara, përfshirë regjistrimin e seancave dëgjimore dhe sistemet e hyrje-daljeve.

Neni 20
Procedura për mbikëqyrjen e infrastrukturës TIK

1. Çdo strukturë IT në gjykatat e Republikës së Shqipërisë ka detyrimin të zbatojë procedurat e mëposhtme për mbikëqyrjen e infrastrukturës TIK:

a) Identifikimi i burimeve kritike të informacionit, duke evidentuar komponentët thelbësorë për funksionimin e përditshëm të gjykatës, si: serverat, rrjeti, bazat e të dhënave, pajisjet e sigurisë fizike dhe elemente të tjera të infrastrukturës;

b) Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive, duke caktuar personat përgjegjës për verifikimin e infrastrukturës së Sistemit, si dhe një person përgjegjës për koordinimin e mbikëqyrjes dhe reagimin ndaj incidenteve të sigurisë;

c) Vlerësimi i rrezikut, përmes identifikimit të vulnerabiliteteve dhe rreziqeve të mundshme për infrastrukturën e Sistemit që cenojnë sigurinë fizike dhe sigurinë e informacionit, nëpërmjet kontrolleve periodike;

ç) Zbatimi i politikave dhe standardeve të sigurisë, duke respektuar aktet e dokumentuara për sigurinë e informacionit dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së Sistemit, përfshirë politikat e aksesit, kontrollin e hyrje-daljeve, menaxhimin e privilegjeve dhe aksesin në ambientet e serverave;

d) Menaxhimi i gjurmëve (*log*-eve) dhe monitorimi i sistemeve, duke verifikuar dhe monitoruar aktivitetin e rrjetit dhe të Sistemit, duke ruajtur *log*-et përkatëse dhe duke përdorur mjete automatike për identifikimin e tentativave të paautorizuara, ndryshimeve të papritura të konfigurimit apo shkeljeve të politikave të sigurisë, me miratimin paraprak të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

dh) *Backup*-i dhe rikthimi i të dhënave, përmes zbatimit të një strategjie të dokumentuar për *backup*-in dhe rikuperimin e të dhënave në rast humbjeje ose dështimi të Sistemit, si dhe testimit periodik të procedurave të rikthimit;

e) Menaxhimi i incidenteve të sigurisë, duke ndjekur procedurat për raportimin, verifikimin dhe trajtimin e incidenteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 21
Platforma *Online Ticketing Service Desk*

1. Platforma elektronike ka për qëllim monitorimin dhe menaxhimin e kërkesave për suport teknik, në lidhje me problematikat e raportuara nga gjykatat për sistemet TIK.

2. Të gjithë nëpunësit IT të gjykatave pajisen me llogari individuale, me qëllim raportimin e problematikave në platformën https://helpdesk.klgj.al.

3. Struktura TIK në Këshill krijon llogarinë e përdoruesit pas marrjes së kërkesës zyrtare nga gjykata për emërimin e nëpunësit IT, së cilës i bashkëlidhet urdhri i emërimit, dhe mbi këtë bazë mundëson aksesin në platformën.

4. Struktura TIK në Këshill mbyll llogarinë e përdoruesit pas marrjes së kërkesës zyrtare me *email* nga gjykata për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së nëpunësit IT, së cilës i bashkëlidhet urdhri për përfundimin e marrëdhënieve financiare.

5. Në përshkrimin e problematikës, nëpunësi IT i gjykatës përcakton shkallën e prioritetit, tipin e problemit dhe mund të bashkëngjisë materiale ndihmëse për të lehtësuar trajtimin e çështjes nga Këshilli.

6. Çdo komunikim që lidhet me detyrën dokumentohet përmes komenteve përkatëse, të cilat përfshihen në raportin mujor të shërbimit. Komentet nuk mund të modifikohen pas kalimit të pesë minutave nga momenti i publikimit të tyre në platformë.

7. Platforma mundëson vënien në dijeni të eprorëve të gjykatave përmes funksionit "*tag*", të cilët njoftohen automatikisht nëpërmjet *email*-it.

8. Çdo nëpunës IT i gjykatës ka akses për të krijuar, korrigjuar dhe parë detyra vetëm për gjykatën ku ushtron detyrën.

9. Platforma mundëson përcaktimin e statusit të detyrës dhe arkivimin e të gjitha kërkesave për suport IT.

10. Platforma mundëson gjenerimin e raporteve në formatet *PDF* dhe *Excel*.

Neni 22
Periodiciteti i raportimit mbi gjendjen e infrastrukturës TIK

1. Kërkesat për mbikëqyrjen e infrastrukturës TIK në gjykata monitorohen çdo ditë nga struktura përgjegjëse e IT-së pranë gjykatës.

2. Rastet e mosfunksionimit vërtetohen me procesverbal, duke përfshirë datën, orën, burimet e të dhënave të konstatuara, llojin e aktivitetit dhe konkluzionet për mosfunksionimin.

3. Çdo tre muaj, struktura përgjegjëse e IT-së përgatit një raport monitorimi me gjetje dhe konkluzione, i cili protokollohet në zyrën e protokollit të institucionit ku është emëruar. Raporti përfshin seksione të veçanta për çdo aktivitet të monitoruar, rezultatet e arritura dhe rekomandimet për veprimet e ardhshme.

4. Në fund të çdo viti, struktura përgjegjëse e IT-së në gjykata përgatit një raport përmbledhës monitorimi mbi gjendjen aktuale të infrastrukturës TIK dhe informon Këshillin.

5. Raporti vjetor mbi zbatimin e kësaj rregulloreje, si dhe çdo problematikë që lidhet me sigurinë e bazës së të dhënave, i dërgohet Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

6. Pas vlerësimit të raporteve të gjykatave, Këshilli ka detyrimin çdo vit të analizojë gjendjen aktuale të infrastrukturës së gjykatave dhe të propozojë masa për zgjidhjen e problematikave të raportuara.

7. Të dhënat e raportuara duhet të ruhen dhe mbrohen në mënyrë të sigurt për të garantuar konfidencialitetin dhe integritetin e tyre.

8. Këshilli merr masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e detyrave të pikës 6, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

9. Këshilli ka të drejtën të verifikojë edhe nga afër infrastrukturën TIK të gjykatave dhe të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve.

10. Këshilli monitoron dhe mbikëqyr përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në gjykata për të siguruar saktësinë dhe sigurinë e të dhënave, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

11. Këshilli ofron asistencë teknike për gjykatat, lidhur me përdorimin e sistemit elektronik.

12. Monitorimi i infrastrukturave TIK dhe i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve mund të kryhet në distancë ose *onsite*.

13. Këshilli organizon trajnime të rregullta për stafin e gjykatës mbi praktikat e sigurisë së informacionit dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së sistemit, për të rritur ndërgjegjësimin mbi rreziqet dhe rolin e tyre në mbrojtjen e informacionit të gjykatës.

KREU IV
POLITIKAT DHE PROCEDURAT PËR SIGURINË E INFRASTRUKTURËS TIK

Neni 23
Menaxhimi i aseteve

1. Gjykatat kanë detyrimin të identifikojnë asetet dhe të përcaktojnë nivelin e duhur të mbrojtjes për

secilin prej tyre. Çdo aset dokumentohet dhe mirëmbahet përmes një inventari të përditësuar rregullisht, në varësi të rëndësisë dhe vlerës së asetit.

2. Të gjitha asetet duhet të kenë një zotërues të përcaktuar, i cili është përgjegjës për kontrollin, zhvillimin, përdorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e aseteve brenda juridiksionit të tij.

3. Punonjësit janë të detyruar të kthejnë asetet që kanë përdorur pas përfundimit të marrëdhënies së punës ose ndryshimit të pozicionit të tyre.

4. Asetet e informacionit përfshijnë, por nuk kufizohen në:

a) *Software*;

b) *Hardware*, përfshirë pajisjet e lëvizshme (laptop, tablet, etj.);

c) Të gjitha asetet e tjera të informacionit, si bazat e të dhënave, kontratat dhe marrëveshjet, dokumentacioni i sistemit, manualet e përdoruesit, materialet e trajnimit, procedurat operative dhe mbështetëse, planet për vazhdimësinë e punës dhe informacionet e arkivuara.

5. Kthimi i aseteve pas përfundimit të punësimit të punonjësve duhet të dokumentohet sipas procedurave standarde, të cilat sigurojnë:

a) Kthimin e dokumenteve, të dhënave dhe manualeve në çdo format, përfshirë edhe asetet e informacionit të zhvilluara ose të përgatitura nga punonjësi, ose kontraktuesi gjatë kryerjes së detyrave;

b) Kthimin e pajisjeve kompjuterike, *software*-ve dhe pajisjeve të lëvizshme si loptop, tablet etj.;

c) Verifikimin e aseteve të kthyera kundrejt inventarëve të aseteve;

ç) Kompensimin për asetet që nuk janë kthyer, bazuar në kriteret për amortizimin dhe vlerën e zëvendësimit të llojit të asetit të humbur;

d) Identifikimin e pajisjeve të aksesit, kartave dhe çelësave të pakthyer, për të parandaluar aksesin e paautorizuar dhe për të siguruar mbrojtjen e të dhënave.

Neni 24
Klasifikimi i informacionit

1. Klasifikimi i informacionit përfshin:

a) Sigurimin që informacioni të ketë nivelin e duhur të mbrojtjes;

b) Ofrimin e mundësisë për punonjësit që të identifikojnë dhe të zbatojnë kërkesat ligjore, lidhur me trajtimin dhe shpërndarjen e informacionit në një mënyrë të thjeshtë, të standardizuar dhe të sigurt ligjërisht.

Neni 25
Autentifikimi dhe autorizimi

1. Kontrolli i aksesit dhe krijimi i llogarive të përdoruesve kryhet duke u caktuar privilegjet përkatëse.

2. Përdoruesve në gjykata dhe në Këshill u sigurohet akses vetëm në infrastrukturat që shërbejnë sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe për të cilat ata janë autorizuar në mënyrë specifike.

3. Aksesi në këto infrastruktura kontrollohet në të gjitha nivelet: perimetri i rrjetit, kompjuterat individualë, ruterë, porta, *workstation*-et dhe serverat.

Neni 26
Procedura e regjistrimit dhe çregjistrimit të përdoruesit

1. Platforma e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve është e bazuar në *web* dhe përdor minimalisht mekanizmat standard të hyrjes me emër përdoruesi dhe fjalëkalim.

2. Përdoruesit kategorizohen sipas roleve dhe grupet e përdoruesve përcaktohen në përputhje me rolet e tyre.

3. Platforma mund të integrohet me Direktorinë Aktive (DA) për identifikimin e përdoruesve të brendshëm të gjykatave dhe zbatimin e rregullave të DA-së. Kjo përfshin informacionin:

a) emër dhe mbiemër i përdoruesit;

b) fjalëkalim fillestar, i cili më pas personalizohet nga përdoruesi;

c) roli i përdoruesit në sistem.

4. Grupet e përdoruesve dhe rolet e tyre janë të përcaktuara në aneksin I të kësaj rregulloreje.

5. Përdoruesit e jashtëm që kërkojnë vetëm informacion nuk kanë nevojë për llogari, pasi mund të aksesojnë informacionin e shfaqur në portalet përkatëse sipas nivelit të gjykatës.

6. Regjistrimi dhe çregjistrimi i përdoruesve për gjykatat bëhet me miratimin e kryetarit të gjykatës.

7. Struktura TIK është përgjegjëse për menaxhimin e aksesit në rrjet dhe bazën e të dhënave dhe zbaton procedurat e mëposhtme.

a) Regjistrimi:

i. miratimi për hapjen e llogarisë së përdoruesit;

ii. sigurimi i kërkesës për akses në rrjetin e gjykatave;

iii. verifikimi që kërkesat për akses përputhen me përgjegjësitë e punës së përdoruesit;

iv. informimi i përdoruesit mbi kushtet e aksesit;

v. kufizimi i aksesit sipas privilegjeve të roleve.

b) Çregjistrimi:

i. shqyrtimi i të drejtave të aksesit kur një përdorues largohet ose ndryshon detyrën ose përgjegjësitë, në përputhje me vendimet e Këshillit të Gjykatës;

ii. shqyrtimi i të drejtave të aksesit në rast ristrukturimi të institucionit.

8. Dhënia dhe revokimi i kredencialeve të autentifikimit kontrollohet sipas procedurave të përcaktuara në aneksin III.

9. Struktura TIK ka autoritetin për lëshimin dhe rivendosjen e fjalëkalimeve:

a) Kredencialet e përdoruesve të rinj jepen vetëm pas miratimit të Kryetarit të Gjykatës;

b) Fjalëkalimet nuk ruhen në formë të pambrojtur;

c) Fjalëkalimet fillestare të sistemeve që vendosen në gjykata duhet të ndryshohen sipas standardeve;

ç) Revokimi i kredencialeve të autentifikimit bëhet sipas procedurave të miratuara.

10. Fjalëkalimet duhet të jenë komplekse dhe të përputhen me standardet e sigurisë të cituara më poshtë.

11. Përdoruesit janë përgjegjës të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të autentifikimit, të mos e ndajnë me të tjerët, të shmangin regjistrimin e tij dhe përdorimin e të njëjtit fjalëkalim për llogari të tjera.

Neni 27

Standardi mbi krijimin e llogarive të përdoruesve

1. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi për përdoruesit e thjeshtë:

a) Kërkesat e sigurisë për identifikimin e përdoruesve:

i. çdo përdorues pajiset me një identifikues personal, i cili përbëhet nga emri_mbiemri i përdoruesit;

ii. përdoruesi është përgjegjës për përdorimin dhe keqpërdorimin e identifikuesit të tij, në përputhje me rolin përkatës;

iii. identifikuesi dhe roli i përdoruesit përcaktohen nga eprori përkatës, i cili mund të delegojë këtë përgjegjësi për krijimin e përdoruesve të rinj në sistem;

iv. njësia e burimeve njerëzore informon menjëherë administratorin e sistemit dhe Drejtorinë e IT për çdo përdorues të ri, ndryshim pozicioni ose largim përdoruesi, së bashku me rolin përkatës në sistem;

v. çdo përdorues pajiset me një fjalëkalim unik për të aksesuar sistemin sipas rolit të tij. Përdoruesi është përgjegjës për përdorimin dhe keqpërdorimin e fjalëkalimit të tij;

vi. me pajisjen e përdoruesit me fjalëkalim, ai është përgjegjës për çdo veprim që kryhet në sistem nga llogaria e tij.

b) Kërkesat e sigurisë për fjalëkalimin e përdoruesve:

i. fjalëkalimi duhet të ketë të paktën 10 karaktere dhe të përmbajë kombinim germash kapitale dhe të vogla, një numër (0–9) dhe një simbol (p.sh. *, $, %, #, &);

ii. fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë emrin e përdoruesit ose pjesë të tij më shumë se 3 karaktere;

iii. fjalëkalimet ndryshohen çdo 90 ditë. Çdo fjalëkalim i dyshuar për kompromet im duhet të raportuar dhe ndryshuar menjëherë;

iv. nuk mund të përdoren dhjetë fjalëkalimet e fundit;

v. fjalëkalimet nuk duhet të komunikohen tek të tjerët, të shkruhen në letër ose të ruhen në skedarë, ose bazë të dhënash në kompjuter;

vi. fjalëkalimet duhet të jenë të maskuara dhe nuk printohen ose përfshihen në raporte ose log-e.

Neni 28

Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi për administratorin e sistemeve TIK në gjykata

1. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi i administratorit të sistemeve TIK i komunikohet vetëm këtij personi nga administratorët e sistemit. Pas marrjes së fjalëkalimit, përdoruesi duhet ta ndryshojë menjëherë. Në rast leje vjetore, sëmundjeje apo arsye të tjera madhore, emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi dorëzohet tek administratorët e sistemit me anë të një procesverbali.

2. Në rast largimi nga detyra, administratorët e sistemeve plotësojnë formularin e miratuar mbi

dorëzimin e detyrës sipas aneksit II, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Kërkesat e sigurisë për fjalëkalimin e administratorit të bazës së të dhënave:

i. fjalëkalimi duhet të ketë të paktën 10 karaktere;

ii. fjalëkalimi duhet të përmbajë një kombinim të germave kapitale dhe të vogla, numrave dhe karaktereve speciale si ($!, @, # etj.);

iii. fjalëkalimet ndryshohen çdo 30 ditë. Në rast kompromet imi, ato duhet të ndryshohen menjëherë;

iv. fjalëkalimi nuk mund t'u komunikohet të tjerëve, të shkruhet në letër ose të ruhet në skedarë, ose baza të dhënash;

v. fjalëkalimi duhet të jetë i maskuar dhe nuk printohet ose përfshihet në raporte ose log-e;

vi. fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë të dhëna personale ose emrin e institucionit/gjykatës;

vii. nuk lejohen karakteret: \, ~ ose <;

viii. nuk lejohen hapësira ("*space*") ose tabela ("*tab*");

ix. administratorët e sistemit duhet të forcojnë sistemet për të penguar tentativa të dyshimta, duke përdorur metoda për të zbutur sulmet me fjalëkalim "forcë brutale";

x. sistemet nuk duhet të lejojnë hyrjen e përdoruesit pa një fjalëkalim;

xi. administratorët e sistemit duhet të rivendosin fjalëkalimet për llogaritë e përdoruesve ose të kërkojnë nga përdoruesit ndryshimin e tyre kur përdorimi i një fjalëkalimi të njëjtë rrezikon akses të paautorizuar.

Neni 29

Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi për administratorin e infrastrukturave fizike TIK në gjykata

1. Infrastruktura fizike TIK përbën komponentin kryesor ku ruhen dhe përpunohen të dhënat e sistemit. Performanca dhe siguria e sistemit mund të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga administrimi dhe optimizimi i serverave të bazës së të dhënave, ndaj këta duhet të mirëmbahen dhe monitorohen rregullisht.

2. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi përkatës i komunikohen vetëm administratorit të autorizuar nga administratorët e sistemit.

3. Kërkesat e sigurisë për fjalëkalimin e administratorit të sistemit të menaxhimit të bazës së të dhënave përfshijnë:

i. fjalëkalimi duhet të përmbajë minimumi 10 karaktere;

ii. fjalëkalimi duhet të përmbajë kombinim të germave të mëdha dhe të vogla, numrave dhe karaktereve speciale (si !, @, #, etj.);

iii. fjalëkalimi duhet të ndryshohet çdo 30 ditë. Në rast të kompromet imit të fjalëkalimit, ai duhet të ndryshohet menjëherë;

iv. fjalëkalimi nuk duhet t'u komunikohet personave të tjerë, të shkruhet në letër ose të ruhet në skedarë apo baza të dhënash në kompjuter;

v. fjalëkalimi duhet të jetë i maskuar dhe nuk duhet të printohet apo të përfshihet në raporte ose në log-e të sistemit.

Neni 30

Autentifikimi

1. Autentifikimi përbën një mekanizëm thelbësor për garantimin e sigurisë së sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), me qëllim parandalimin e aksesit të paautorizuar në sistemet dhe të dhënat e institucionit. Administrimi i informacionit dhe kredencialeve të llogarive të administratorëve duhet të kryhet me masa më të rrepta sigurie në krahasim me llogaritë e përdoruesve të zakonshëm.

2. Në kuadër të menaxhimit të autentifikimit duhet të zbatohen këto rregulla:

a) Të krijohen vetëm llogaritë e përdoruesve që janë të domosdoshme për funksionimin e sistemeve;

b) Për çdo llogari përdoruesi të përcaktohen qartë të drejtat e aksesit, në përputhje me funksionin dhe përgjegjësitë përkatëse;

c) Të krijohen llogari të veçanta për përdoruesit dhe për administratorët e sistemeve, me nivele të ndryshme të drejtash aksesi sipas rolit;

ç) Llogaritë që nuk përdoren të çaktivizohen (*disable*) ose të fshihen në mënyrë të menjëhershme;

d) Llogaritë e paracaktuara, të krijuara gjatë instalimit të sistemeve të fshihen ose të çaktivizohen në rast se nuk janë të nevojshme për funksionimin e sistemit.

Neni 31
Kontrolli i aksesit

1. Të përdoret *firewall* (mur zjarri) për mbrojtjen e serverave të bazës së të dhënave nga aksesi i paautorizuar.

2. Aksesi në serverat e bazës së të dhënave të kufizohet vetëm për terminalet e autorizuara ose për terminalet që i përkasin të njëjtit segment rrjeti.

3. Aksesi në skedarët e konfigurimit të bazës së të dhënave lejohet vetëm për administratorët e sistemit.

4. Aksesi në skedarët e shkrimeve (*script*-eve) të kufizohet vetëm për administratorët.

5. Të kryhet kontroll i rregullt i të drejtave të aksesit në skedarët e konfigurimit të bazës së të dhënave.

Neni 32
Përdorimi i memorieve të jashtme

1. Lidhja e memorieve të jashtme me serverin e bazës së të dhënave të kufizohet vetëm në rastet e nevojshme dhe të kontrollohet aksesi ndaj tyre.

2. Të ruhen *log*-et për çdo lidhje dhe akses në memoriet e jashtme.

3. Të kryhen rishikime periodike, lidhur me përdorimin e memorieve të jashtme. Këto rishikime duhet të realizohen veçanërisht para implementimit të sistemeve, aplikacioneve ose shërbimeve të reja, si dhe në rastet e ndryshimeve të konsiderueshme.

Neni 33
Siguria operacionale, auditimi dhe regjistrimi

1. Monitorimi dhe regjistrimi i veprimeve të përdoruesve, ndryshimet e konfiguracionit dhe aksese të tjera të ndjekura, si dhe identifikimin e veprimeve të dyshimta ose të paautorizuara, duke mundësuar hetimin e incidenteve të sigurisë.

2. Të zbatohen kontrolle për të kufizuar mundësitë për rrjedhje të informacionit, duke:

a) Analizuar kodet e dëmshme (*malicious code*);

b) Monitoruar përdorimin e burimeve në sistemet e informacionit;

c) Përdorur *software* që konsiderohen të një integriteti të lartë;

ç) Monitoruar në mënyrë të rregullt sistemet e informacionit;

d) Ndarë ambientet e testimit nga ambientet operacionale.

Neni 34
Mbrojta nga programet keqdashëse

1. Të gjitha pajisjet e teknologjisë duhet të jenë të mbrojtura nga programet keqdashëse, përfshirë viruset e kompjuterave.

2. Struktura TIK në gjykata dhe Këshill duhet të mbrojnë rrjetin dhe bazën e të dhënave nga kërcënimet, duke ndërmarrë aktivitete të tilla; si:

a) Përdorimi i *software*-ve për skanimin, zbulimin dhe mbrojtjen nga kërcënimet ndaj rrjetit dhe bazës së të dhënave;

b) Ndalimi i përdorimit të *software*-ve të paautorizuar;

c) Kontrolli i dokumenteve, përfshirë bashkëlidhjet e postës elektronike dhe shkarkimet e skedarëve nga interneti, për *malware* përpara përdorimit.

Neni 35
Ruajtja dytësore e të dhënave (*Backup*)

1. I gjithë informacioni në bazën e të dhënave duhet të ruhet në një ambient dytësor, në mënyrë që të garantohet rikthimi i të dhënave në gjendjen e mëparshme në rast humbjeje ose shkatërrimi. Struktura TIK në gjykata dhe Këshill duhet të përcaktojë dhe dokumentojë procesin e *backup*-it dhe *recovery*-it.

2. Dokumentimi i proceseve të *backup*-it dhe *recovery*-it përfshin:

a) Llojin e informacionit që do të përfshihet në procesin e *backup*-it;

b) Frekuencën në të cilën do të kryhet *backup*-i;

c) Menaxhimin e medias së *backup*-it (periudha e mbajtjes dhe modeli i cikleve);

ç) Metodat për kryerjen dhe vlerësimin e *backup*-it;

d) Metodat për *recovery* të informacionit.

3. Procedurat e *backup*-it dhe *recovery*-it duhet të testohen rregullisht për të verifikuar funksionimin e tyre. Procedura e *backup*-it duhet të rishikohet çdo vit.

Neni 36
Kryerja e *backup*-it

1. *Backup*-i i të dhënave në sistem kryhet sipas frekuencës së përcaktuar, si më poshtë:

a) Kryhet *backup* çdo ditë nga e hëna në të premte në orën 17:30;

b) Kryhet *full backup* çdo javë, ditën e premte në orën 20:00;

c) Kryhet *full backup* çdo muaj, ditën e fundit të muajit në orën 20:00. Pas kryerjes së *backup*-it mujor fshihen manualisht *backup*-et javore;

ç) Kryhet *full backup* në fund të çdo viti;

d) Pas kryerjes së *backup*-it vjetor ruhen 12 *backup*-et e fundit mujore dhe fshihen manualisht *backup*-et mujore të vitit të kaluar;

dh) Në çdo moment duhet të ekzistojnë *backup*-et vjetore dhe 12 *backup*-et e fundit mujore.

Neni 37
Emërtimi i *backup*-it

1. Të gjitha *backup*-et emërtohen duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

a) emërtimi i sistemit;

b) data: dita, muaji dhe viti.

Neni 38
Gjurma/*log*-et dhe monitorimi

1. Struktura TIK në Këshill siguron gjenerimin, ruajtjen dhe menaxhimin e *log*-eve për të monitoruar aktivitetin e sistemeve.

2. Sektori përgjegjës përcakton nivelin e detajimit të *log*-eve bazuar në vlerën dhe ndjeshmërinë e aseteve të informacionit, rëndësinë kritike të sistemit dhe burimet e nevojshme për të shqyrtuar dhe analizuar.

3. *Log*-et përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

a) përshkrimin e ngjarjes së ndodhur;

b) kohën e ngjarjes;

c) rëndësinë e ngjarjes.

4. Nevojitet sinkronizimi i orës në të gjitha sistemet përkatëse të përpunimit të informacionit brenda gjykatës dhe në Këshill, ose në *domain* sigurie, me një burim të vetëm kohe referimi.

Neni 39
Kontrollet e sigurisë detektuese dhe evidentuese

1. Veprimet që lenë gjurmë në sistemin e menaxhimit të çështjeve janë:

a) Krijimi, leximi, modifikimi ose fshirja e informacionit konfidencial, duke përfshirë informacionin konfidencial mbi autentifikimin;

b) Krijimi, ndryshimi ose fshirja e informacionit që nuk përfshihet në pikën "a".

Neni 40
Kufizimi i instalimit të *software*-ve

1. Instalimi i pakontrolluar i *software*-ve në pajisjet kompjuterike mund të shkaktojë dobësi që sjellin rrjedhje të informacionit, humbje të integritetit, incidente sigurie ose shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale. Përdoruesit duhet të komunikojnë me strukturën TIK për autorizimin e çdo instalimi.

2. Struktura TIK krijon një listë të *software*-ve të lejuara për instalim, e cila miratohet nga Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit. Çdo *software* jashtë listës duhet të kalojë proces rishikimi dhe miratimi, dhe instalimi bëhet vetëm nga personi IT i autorizuar.

Neni 41
Siguria dhe mbrojtja e pajisjeve

1. Të gjitha pajisjet e gjykatave duhet të mbrohen fizikisht nga kërcënimet e sigurisë dhe rreziqet e ambientit.

2. Masat mbrojtëse për pajisjet kompjuterike përfshijnë:

a) Ambienti i përdorimit të pajisjeve të ketë temperaturën dhe lagështinë e duhur;

b) Sigurimi i mbrojtjes nga rrufetë dhe rreziqet mjedisore, si: uji, pluhuri dhe rrezet e diellit;

c) Informimi i punonjësve mbi praktikat e sigurisë në vendin e punës;

ç) Ruajtja e pajisjeve që nuk përdoren në vende të sigurta dhe të mbyllura për të parandaluar aksesin e paautorizuar.

3. Pajisjet duhet të mbrohen nga ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike dhe nga dështimet e shërbimeve mbështetëse, dhe të mirëmbahen në

mënyrë të vazhdueshme për të garantuar disponueshmërinë dhe integritetin e tyre.

4. Kompjuterat personalë (PC) nuk duhet të vendosen në vende ku personat e paautorizuar mund të shohin informacionet; instalimi ose transferimi i tyre bëhet vetëm nga personel i trajnuar dhe i autorizuar.

5. Pajisjet që mirëmbahen ose riparohen nga kontraktues duhet të mbrohen sipas ndjeshmërisë së informacionit dhe vlerës së pajisjes. Struktura TIK përcakton nëse riparimi ose mirëmbajtja mund të kryhet jashtë ambienteve të institucionit.

6. Para asgjësimit ose ripërdorimit të pajisjeve elektronike që përmbajnë të dhëna, struktura IT duhet të verifikojë që çdo të dhënë sensitive dhe program i licencuar të fshihet ose mbishkruhet në mënyrë të sigurt, duke dokumentuar procesin me një procesverbal.

Neni 42
Siguria e ambienteve të punës

1. Përdoruesit duhet të mbrojnë hapësirën e tyre të punës dhe pajisjet sa herë nuk janë prezent, duke:

a) Siguruar dokumentet dhe pajisjet e lëvizshme në një vend të kyçur;

b) Bllokuar PC-në me fjalëkalim;

c) Fikur kompjuterat në fund të ditës;

ç) Mbyllur dyert dhe dritaret;

d) Kontrolluar printerët për të siguruar që nuk ka informacione sensitive të lëna në pritje.

Neni 43
Siguria e dhomës së serverave

1. Çdo strukturë TIK duhet të zbatojë vendimin nr. 14, datë 19.12.2022, "Për standardet e ndërtimit dhe administrimit të dhomës së serverave për sistemin e drejtësisë", miratuar nga Bordi drejtues i QTI-së.

2. Çdo strukturë TIK duhet të zbatojë VKM-në nr. 538, datë 8.7.2020, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për garantimin e rregullit e të sigurisë në gjykata dhe prokurori".

Neni 44
Kontrolli dhe menaxhimi i rrjetit

1. Struktura TIK në gjykata implementon kontrolle të sigurisë për infrastrukturën e rrjetit dhe sistemet e menaxhimit të sigurisë në rrjetin e brendshëm të gjykatës, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së informacionit. Kontrollet përfshijnë asetet e rrjetit që kanë nevojë për mbrojtje, duke përfshirë:

a) Informacionin e ruajtur, si përmbajtja në *cache* dhe skedarët e përkohshëm;

b) Infrastrukturën e rrjetit;

c) Informacionin mbi konfigurimet e rrjetit, përfshirë konfigurimin e pajisjeve, kontrollet e aksesit, rutimin dhe fjalëkalimet;

ç) Informacionin mbi menaxhimin e rrjetit.

Neni 45
Kontrolli i konfigurimeve

1. Për të ruajtur integritetin e rrjetit të brendshëm të gjykatës, Struktura TIK në gjykata është përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e ndryshimeve në informacionin e konfigurimeve të pajisjeve të rrjetit, duke përfshirë:

a) Të dhënat e konfigurimit;

b) Kontrollin e aksesit;

c) Afatet dhe parametrat e fjalëkalimeve.

Neni 46
Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së informacionit

1. Një incident i sigurisë së informacionit është një ngjarje ose një seri ngjarjesh të padëshiruara apo të papritura që kërcënojnë privatësinë ose sigurinë e informacionit. Këto incidente përfshijnë çdo përdorim, zbulim, akses, ruajtje ose asgjësim të informacionit, qoftë aksidentale ose të qëllimshme, pa autorizimin e personit përgjegjës.

2. Për të garantuar një përgjigje të shpejtë, efektive dhe të rregullt ndaj incidenteve, përgjegjësitë për menaxhimin e tyre ndahen dhe krijohen procedura të qarta.

3. Llojet e mundshme të incidenteve të sigurisë që raportohen përfshijnë:

a) Përpjekjet e përsëritura të aksesit të paautorizuar;

b) Mohimi i shërbimit;

c) Zbulimi i kodeve të dëmshme;

ç) Defektet e sistemeve;

d) Shpërndarja e kredencialeve të përdoruesve.

4. Dyshimet për incidente të sigurisë së informacionit raportohen menjëherë te Struktura

TIK në gjykatën përkatëse dhe në Këshill. Struktura vlerëson çdo ngjarje të sigurisë së informacionit dhe vendos nëse duhet të klasifikohet si incident i sigurisë.

5. Njohuritë e fituara nga analiza dhe zgjidhja e incidenteve duhet të përdoren për të minimizuar gjasat dhe ndikimin e incidenteve të ardhshme.

Neni 47
Incidentet e sigurisë në Teknologjinë e Informacionit (TI)

1. Incidentet e sigurisë TIK shkaktohen nga *malware*, të cilat janë programe ose sekuenca kodi që vetëinstalohen në aplikacione të tjera dhe mund të dëmtojnë sistemin. Këto mund të shkaktojnë ndryshime të paautorizuara në të dhëna ose dëmtime të hard diskut. Shenjat e infektimit përfshijnë, veprime të kompjuterit pa komandën e përdoruesit, ndryshime në ekran, zhdukjen ose lëvizjen e karaktereve dhe të tjera.

2. Veprimet e përdoruesit në rast dyshimi për *malware*:

a) Ndërprerja menjëherë e punës në kompjuter;

b) Shkëputja e kabullit të rrjetit nga kompjuteri;

c) Sigurimi që kompjuteri dhe *software*-i nuk përdoren nga persona të tjerë;

ç) Raportimi i incidentit tek struktura TIK e institucionit, e cila mban një procesverbal për çdo veprim të dyshuar si pjesë e incidentit.

3. Pas raportimit, incidenti duhet të trajtohet në mënyrë efikase dhe të shpejtë deri në zgjidhjen e tij. Kategorizimi i incidenteve kibernetike ndihmon në planifikimin e veprimeve, duke siguruar respektimin e afateve të raportimit në bazë të rëndësisë së infrastrukturës së informacionit.

4. Çdo strukturë TIK në gjykata zbaton rregulloren për kategoritë e incidenteve kibernetike dhe formatin e elementeve të raportit, sipas udhëzimeve të miratuara nga AKSK-ja.

5. Çdo çështje që lidhet me privatësinë ose sigurinë e informacionit i drejtohet Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

Neni 48
Privatësia dhe përmbajtja e të dhënave

1. Siguria e mjeteve të monitorimit duhet të garantojë mbrojtjen e privatësisë dhe integritetin e të dhënave.

2. Kjo përfshin mbrojtjen e të dhënave personale të përdoruesve, të dhënave të transmetuara në rrjet dhe të dhënave të ruajtura në mjetet e monitorimit, në përputhje me aktet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, dokumentin elektronik dhe komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

KREU V
DISPOZITA E FUNDIT

Neni 49
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKS I
TË DREJTAT E PËRDORUESVE TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE

Tabela 1: Hierarkia e roleve sipas modelit RBAC

Nivel	Roli	Funksioni kryesor	Statusi
1	KLGJ	Pronari i sistemit dhe përcaktimi i politikave	Pronari i Sistemit
2	Kryetari i gjykatës	Administrim institucional	Administrator institucional
3	Zëvendëskryetari	Mbështetje drejtimi	Administrator delegues
4	Administratori /arkitekti/zhvilluesi i sistemit (IT)	Administrim teknik	Administrator teknik
5	Gjyqtari	Administrim i çështjes	Administrator i çështjes
6	Kancelari i gjykatës	Administrim administrativ	Administrator administrativ
7	Kryesekretari	Koordinim administrativ	Mbikëqyrje operative
8	Sekretari gjyqësor	Mbështetje procedurale	Mbështetje operative

9	Sekretari regjistrues	Regjistrim dosjesh	Regjistrim
10	Ndihmësmagjistrati	Mbështetje juridike	Mbështetje
11	Këshilltari ligjor	Mbështetje juridike	Mbështetje
12	Ndihmësi ligjor	Mbështetje juridike	Mbështetje
13	Nëpunësi i financë/buxhetit	Funksione financiare	Akses i kufizuar
14	Stafi administrativ (HR, arkiv, media etj.)	Mbështetje institucionale	Akses i kufizuar
15	Përdoruesi i gjykatës	Përdorim i kufizuar	Përdorues
16	Inspektori/audituesi	Monitorim	Kontroll
17	ILD	Auditim dhe mbikëqyrje	Kontroll

Tabela 2: Të drejtat sipas roleve (RBAC)

Roli	Administrim sistemi	Administrim çështje	Konfigurim teknik	Monitorim	Akses në dokumente
KLGJ	✓	✗	✗	✓	sipas rolit
Kryetari i gjykatës	✓	✓	✗	✓	✓
Zëvendëskryetari	✓	✓	✗	✓	✓
IT (admin/arkitekt/zhvillues)	✓	✗	✓	✓	i kufizuar
Gjyqtari	✗	✓	✗	✗	✓ i plotë
Kancelari	✓	✓	✗	✓	✓
Kryesekretari	✓	✓	✗	✓	✓
Sekretari gjyqësor	✗	✓	✗	✗	✓
Sekretari regjistrues	✗	regjistrim	✗	✗	i kufizuar
Ndihmësmagjistrati	✗	✓	✗	✗	✓ sipas autorizimit
Këshilltari ligjor	✗	✓	✗	✗	✓
Ndihmësi ligjor	✗	✓	✗	✗	i kufizuar
Financë/buxheti	✗	✗	✗	✗	sipas modulit
Stafi administrativ	✗	✗	✗	✗	minimal
Përdoruesi i gjykatës	✗	✗	✗	✗	minimal
Inspektori/Audituesi	✗	✗	✗	✓	vetëm lexim
ILD	✗	✗	✗	✓	Akses i pa kufizuar vetëm lexim

Tabela 3: Matrica sipas modelit RACI

Aktiviteti	R (përgjegjës për zbatim)	A (përgjegjës për vendimmarrje)	C (konsultohet)	I (informohet)
Politikat dhe rregullat IT	KLGJ	KLGJ	IT / Gjykatat	Përdoruesit
Administrimi teknik i sistemit	IT i gjykatës	Kryetari i gjykatës	KLGJ	Administrata
Menaxhimi i çështjeve	Gjyqtari	Kryetari i gjykatës	Kancelari	IT
Administrimi administrativ	Kancelari/kryesekretar	Kryetari	IT	KLGJ
Regjistrimi i çështjeve	Sekretar regjistrues	Kryetari	Gjyqtari	IT
Monitorimi dhe auditimi	ILD/audites	KLGJ	IT	Gjykata

RBAC: *Role-Based Access Control* – Kontrolli i aksesit bazuar në role (p.sh. gjyqtari sheh vetëm dosjet e veta).

RACI: *Responsible* (Përgjegjës), *Accountable* (Përgjegjës final), *Consulted* (Këshilluar), *Informed* (Informuar).

Matrica RACI: Tabelë që tregon kush bën çfarë në një proces/projekt (R/A/C/I për çdo detyrë).

**** Administratori teknik i sistemit në gjykatë dokumenton çdo ndërhyrje ose veprim teknik të kryer mbi sistemet dhe infrastrukturën TIK. Çdo ndryshim që ndikon në konfigurimin, sigurinë ose funksionimin e sistemit realizohet vetëm pas konfirmimit paraprak nga titullari i institucionit ose autoriteti i deleguar prej tij.*

ANEKSI II
Formulari i miratuar mbi dorëzimin e detyrës

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULAR DORËZIMI NË PËRFUNDIM TË MARRËDHËNIES SË PUNËS SË NËPUNËSIT IT

Gjykata _____

_____.____.202X

1. **Serveri ICMIS/ ARKIT**
   - IP
   - Computer name:
   - Username i serverit Administrator:
   - Password i serverit:
   - A ka të tjerë usera me profil Administrator?
   - Nëse ka të citohen në material.
   - Listo të gjithë userat aktive që përdorin sistemin ICMIS/ ARKIT (kryegjyqtar, gjyqtare, kancelarë, kryesekretarë, sekretare regjistruese, sekretare gjyqësore, arkiviste) .

   Ku realizohet back-up i sistemit, përcakto HDD dhe Cloud (google drive nëse ka).
   - Username i SQL Server:
   - Passwordi:

   Lidhja VPN (Nëse ka)
   - (Për çfarë shërben dhe përdoren apo jo pajisjet shtesë fizike për lidhjen e VPN)
   - Username:
   - Passwordi:

2. **Servera të tjerë (nëse ka):**
   - IP :
   - Computer name:
   - Username i serverit Administrator:
   - Password i serverit:

- A ka të tjerë usera me profil Administrator?
- Nëse ka të shkruhen.
- Listo të gjithë userat aktivë që përdorin sistemin ICMIS/ ARKIT (kryegjyqtar, gjyqtare, kancelare, kryesekretare, sekretare regjistruese, sekretare gjyqësore, arkiviste) .

3. **Sistemi Audio i instaluar në Gjykatë:**
   - Si realizohet back-upi, çfarë lidhje përdoren për back-upin, përcakto vendndodhjen e ruajtjes së regjistrimeve audio që nga viti 2012 e deri më tani. Në cilin vend ruhet tjetër back-upi i regjistrimeve audio?
   - Në kompjuterët e secilës salle a gjenden regjistrimet të kryera lokalisht në secilën prej sallave që nga 2012 e deri më tani?
   - Po në serverin e ICMIS a gjenden regjistrimet audio të gjithë sallave? Nëse po përcakto periudhën që nga 2012 e deri më tani.
   - Në cilin vend ruhet tjetër back-upi i regjistrimeve audio, të tilla si HDD të jashtëm apo vendndodhje tjetër jashtë gjykate?
   - Cilat janë pajisjet shtesë nëpërmjet se cilave realizohet ruajtja e të dhënave (Laptop, dhe HDD) programi përkatës, kush janë kredencialet e njësisë kompjuterike (computer name, IP, user, password etj), të programit nëpërmjet së cilës raportohen, bëhet back-upi?
   - Cilat janë raportet e audios që raportohen në KLGJ apo USAID apo vende të tjera?
   - Përcakto konktaktet përkatëse për KLGJ:

Programi i regjistrimit të mbledhjeve të gjyqtarëve i instaluar (nëse ka)

- Çfarë pajisje përdoret? A është në funksionim ky program? Sa mikrofona ka? Përfshin edhe regjistrim video?
- A janë të ruajtura diku në program apo në kompjuter mbledhjet e mëparshme të bëra që nga instalimi e deri më tani?

4. **Serveri i kamerave**
   - IP:
   - Computer name:
   - User name i serverit :
   - Password:

Programi i kontrollit te kamerave:

- Username:
- Password:
- Usera të tjerë nëse ka:
- Username:
- Password:

- **Përcakto sa kamera janë të lidhura aktualisht.** Sa janë në gjendje pune? Sa janë të defektuara nëse ka të tilla, dhe deri në sa kamera mund të lidhen në pajisjen ekzistuese.

- **Në çfarë diapazoni kohor mund të mbajë regjistrime serveri i kamerave** duke u nisur nga dita aktuale? Përcakto procedurën e ruajtjes së një kopjeje në DVD.
- **A janë të regjistruara edhe me zë të gjitha filmimet e bëra nëpërmjet kamerave?**
- A është mundësia e ruajtjes në një vendndodhje tjetër në HDD apo server apo diku në rrjet?
- Kontaktet e subjektit që referohen për ndonjë problematikë.

A ka sistem tjetër kamerash përveç atij të sipërcituar?

5. **Pc e kartave të Aksesit apo i sistemit të sigurisë**
   - IP:
   - Computer name:
   - Username i pc:
   - Passwordi:

   Programi i Kartave të aksesit
   - Username:
   - Passwordi:
   - Usera të tjerë nëse ka të krijuar me kredencialet e veta:
   - Username:
   - Password:

   Kontakt të subjektit për probleme në software apo për pajisje me kartë aksesi në raste se defektohen ose shtohet personel.

6. **Lidhja e Internetit; pajisja që përdoret; si mundësohet lidhja (lidhje ADSL; fibër optike etj); subjekti që ofron shërbimin; të përcaktohet nëse përdoret IP statike dhe cila është; të përcaktohet gateaway dhe DNS-ja.**
   - **Equipment type MODEL:**
   - Username i pajisjes:
   - Passwordi i pajisjes:
   - Passwordi i Wireless:
   - IP:
   - Kontak të subjektit që ofron shërbimin në raste problemesh me lidhjen e internetit.

   Të dhëna për pajisje audio (nëse ka):

   Equipment type MODEL:

   - IP:
   - Username i pajisjes:
   - Passwordi i pajisjes:
   - Passwordi i Wireless:
   - Ku është i pozicionuar si vendndodhje.

7. **E-mail Zyrtar (GOV):**

- Kontakti me KLGJ në lidhje me hapjen dhe mbylljen e adresave zyrtare nën domain gjykata.gov.al.
- Grupet e krijuara cilat janë dhe të përcaktohen administratorët.
- Mënyrat e konfigurimit të e-mailit në Outlook, smart phone Android dhe Iphone, manualet përkatëse.

8. **Portali i gjykatës:**
   Web: www.gjykata.gov.al

   - User name i administratorit të faqes për sa i përket rifreskimit të të dhënave në portal:
   - Passwordi:
   - Cilat janë rubrikat që rifreskon informacionet administratori i faqes (Specialisti i IT).
   - Në cilën rubrikë bëhen shpalljet për njoftimet e seancave për palët në gjykim? Përcakto rubrikën.
   - Po shpalljet e ardhura nga subjekte të ndryshme p.sh. ato përmbarimore etj. në cilën rubrike afishohen?
   - Si funksionon formulari i aplikimit për marrjen e dokumenteve nga Arkiva e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në portal?
   - Ku shkarkohen këto kërkesa që bëhen nëpërmjet portalit?
   - A ka ndonjë adresë të hapur lidhur me këtë? Nëse po, të përcaktohen kredencialet.
   - Kush i akseson dhe i proceson këto kërkesa dhe nëpërmjet çfarë aplikacioni?
   - Çfarë llogarie përdoret nëse përdoret një e tillë?

9. **Centrali telefonik (nëse ka).**
   - Kompjuter name:
   - IP:
   - Username:
   - Password:
   - Konfigurimet e tjera
   - Përcakto mënyrat e konfigurimit të një numri të ri.
   - Sa është kapaciteti për këtë central?
   - Kush është subjekti që e ka instaluar në raste nëse do të nevojitet kontakti me to të probleme madhore?

10. **Pajisja Kioska (nëse ka)**
    - IP:
    - Username:
    - Password:
    - Çfarë fushash paraqiten në filtrimin a mund të paraqitet edhe fusha të tjera kërkimi? Nëse po përcakto mënyrën si bëhet ky ndryshim.

11. **Pajisja e video konferencave (nëse ka),** listimi i pajisjeve që mundësojnë lidhjen me gjykata të tjera ndërkombëtare.
    - IP statike që përdoren, parametrat që konfigurohen në secilën prej pajisjeve (kamera, boxi audio, etj.) dhe kredencialet që përdoren.

12. **Useri i Microsoft teams (nëse ka) për planifikimin dhe organizimin e sesioneve online që aplikohet për seancat gjyqësore apo edhe me pjesëmarrje të treta**
    - Username:
      Password:
    - (Platforma elektronike e krijuar për lidhje audiovizive për zhvillimin e seancave në distancë me pajisje elektronike, manualet përkatëse).
    - Përcakto nëse ka pajisje shtesë për të realizuar këto lidhje përveç kompjuterave të sallave të gjykimit.
    - A ka manuale përdorimi për administratorin që krijon takimin online dhe për palët pjesëmarrëse në gjykim?

13. **Faqja e Gjykatës në Facebook dhe në Instagram, kredencialet përkatëse (nëse ka).**

14. Shërbimi i fotokopjeve:
    - Sa fotokopje janë sjellë nga subjekti?
    - Sa janë në gjendje punë dhe ku përdoren?
    - Kontaktet përkatëse me firmën. Sa është numri i printimeve deri më tani? Me çfarë komande gjenerohet ky raport?
    - Çfarë praktike ndiqet nëse i kalohet ndonjë dokument financës apo jo lidhur me shërbimet e kryera në periudha kohore të ndryshme?

15. Përcakto sistemet e alarmit në gjykatë të tillë si:
    - Sensorët për zjarrin, metal detektori, sensorët e lëvizjes etj.

16. A janë gjyqtarët pjesë e ndonjë platforme tjetër që nuk është e listuar më lart?
    Nëse po kredencialet e tyre i zotërojnë vetë ata apo janë të ruajtuara diku?
    - Nëse ka gjëra të tjera, platforma të tjera që nuk janë listuar më sipër, të shënohen.

Për çdo detyrë e cila vijon të jetë në proces realizimi në momentin e largimit nga puna, të detajohet statusi mbi të cilin ndodhet dhe të shoqërohet me dokumentacionin përkatës.

Plotësuar nga	**Dorëzuar**
Specialisti IT në proces shkëputje nga ky pozicion	Specialisti IT në Detyrë

ANEKSI III

FORMULARI PËR PËRCAKTIMIN E AKSESIT NË SISTEMIN KOMPJUTERIK

SEKSIONI A (Plotësohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore)

HAPJE LLOGARIE ☐ MBYLLJE LLOGARIE ☐

A1. TË DHËNA IDENTIFIKUESE TË PUNONJËSIT

EMRI														
MBIEMRI														
NUMRI TELEFONIT														

A2. POZICIONI I PUNËS

DEPARTAMENTI														
DREJTORIA														
SEKTORI														
NUMRI I VENDIMIT TË PUNËSIMIT														

PLOTËSOI: _____
MIRATOI:_____

SEKSIONI B (Plotësohet nga eprori i drejtpërdrejtë)

_____

Llogaria e e_mail-it													
Llogaria e e_mail-it të përbashkët të Drejtorisë/Sektor													
Llogaria të sistemeve të tjera													

PLOTËSOI: _____ **MIRATOI:**

SEKSIONI C (Plotësohet nga Drejtoria IT)

Llogaria	e krijuar	e mbyllur
në e_mail		
në e_mail-it të përbashkët të Drejtorisë/Sektor		
në Active Directory		
në Microsoft Teams		
në M-files		
në Kartës së Aksesit		

PLOTËSOI: _____
MIRATOI:_____

KËRKESË
Nr. 84/7, datë 24.4.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi projektit 'Rikonstruksion i trotuareve, lagjja 'Sheh', Bashkia Kavajë"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Kavajë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Kavajë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 452,308 (katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I TROTUAREVE, LAGJJA 'SHEH', BASHKIA KAVAJË"

Nr.	Pronari			Të dhënat hipotekare										Vlerësimi për "truall"			Vlerësimi për "ndërtesë"			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Arë (m^2)	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volum	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (leke/m^2)	Vlera (lekë)		
1	Hysen Dhurata Flutura Gezim Mentor Yllka Ilaria Nikolas Yllka	Zenel Qemal Qemal Qemal Fehemi Fehemi Claudio Gazment Fehmi	Shehi Cara Beqari Shehi Shehi Gjeçi (Shehi) Taddei Shehi Shehi	Kavajë	8552	8/148	Truall	577		577	194.82	10	128	58.4	7,745	452,308				452,308	Sek. C. Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa dhe parcela ndërtimore e objektit me nr. 8/148-ND vol. 41-119. Sek. D. Mbi këtë pasuri ndodhet një ndërtim i paligjshëm. Sek. E. Lëshuar certifikata e pronësisë me sipërfaqe sipas aktit të pronësisë 2458.
	VLERA TOTALE																			452,308	

KËRKESË
Nr. 519/5, datë 27.4.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare (Pika Doganore Morinë)"', me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 184,982 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 184,982 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHESHEVE DHE ZONAVE KRYESORE NË AFËRSI TË PIKAVE DOGANORE SHQIPTARE (PIKA DOGANORE MORINË)"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë							Vlerësimet për shpronësim sipas llojit							
											Truall			Arë				
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall	Arë	Ndërtesë	Sipërfaqja e shpronësuar m²	Çmimi	Vlera	Sipërfaqja e shpronësuar m²	Çmimi	Vlera	Vlera totale (lekë)	Shënime
1	Shtet			2724	90/2	Truall	187	187		187	160	0.00	0.00			-	0.00	Pasuria administrohet nga Ministria e Brendshme pasuria është dy kat banesë dokumenti 0133 Kukës me 31.10.2008.
2	Shtet			2724	90/1	Truall	171	171		171	72	0.00	0.00			-	0.00	Pasuria administrohet nga Ministria e Brendshme pasuria është një kat banesë dokumenti 0133.
3	Kujtim Ylber Rive	Islam Islam Iljaz	Duraku Duraku Duraku	2724	90/6	Truall	1,971	1971			670	203	136,010			0	136,010	Pasuria kufizohet sipas urdhrit të regjistruesit nr. 197, datë 13.10.2016, sipas dokumentit nr. 0072, datë 5.7.2006, pasuria është truall.
4	Qemal		Duraku	2724	80/9	Arë	283		283					22	132	2,904	2,904	Ref. 062 pajisur me certifikatë datë 8.6.2009, certifikata e parë humbur sipas deklaratës noteriale nr. 32828 rep., nr. 1807 kol., datë 31.10.2008, urdhër regjistruesi nr. 113, datë 8.6.2009, me sip. 28866 m² është përfshirë dhe sip. nen objekte e cila është fshirë me vendimin nr. 39, datë 2.6.2009, të kryeregjistruesit për pas. 85/19, v. 8, f. 190, pas. 85/18, v. 8, f. 175, pas. 85/19, n. 12, v. 8, f. 193.
5	Lulzim	Zaim	Duraku	2724	80/2	Arë	650		650					152	132.00	20,064.00	20,064	
6	Zaim	Ajet	Duraku	2724	80/1	Arë	760		760					197	132.00	26,004.00	26,004.00	
7	Shtet			2724	86	Pa frut	5,000							337	0.00	0.00	0.00	
	Shuma paraprake																184,982.00	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/04/29 13:56:27 +02'00'
4963c2152fa344e8b01a450a0f507afa2

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)